

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6007  
E shtunë, 22 shkurt 2020  
çmimi 0.40 €

## Ministrja e Jashtme e Xhamajkës thotë se nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI BERISHA | FAQE 4-5

# TAKSËN 100 PËR QIND DO TA MBROJTMË ME TË GJITHA FORMAT DEMOKRATIKE



Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, beson se brenda këtij muaji do të thirret seanca e jashtëzakonshme parlamentare për ta kundërshtuar heqjen e taksës ndaj mallrave serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

thënë se deri më tani kanë arritur t'i mbledhin mbi 30 nënshkrime të deputetëve opozitarë për këtë çështje. Berisha ka vlerësuar se duhet të ketë konsensus të të gjitha partive politike për mbajtjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe. Deputeti i AAK-së ka

vlerësuar se paralajmërimi i qeverisë për zëvendësim të takës me reciprocitet është mashtrim. "Ne do t'i përdorim të gjitha format demokratike për ta penguar vendimin e qeverisë për heqjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe", ka thënë Berisha

## 120 policë me probleme të rënda shëndetësore

Policia e Kosovës ka dhënë hollësi për gjendjen shëndetësore të zyrtarëve policorë. Sipas Policisë, janë rreth 120 zyrtarë policorë me prob-

leme shëndetësore, e prej tyre 20 janë me probleme shëndetësore të natyrës psikologjike, të cilët janë liruar nga arma zyrtare | FAQE 3



## OPINION

VITI I VETMISË F. 14

H. MUJAJ

## AKTUALE

POLICIA SHQIPTARE ARRESTON 115 PERSONA PËR ORGANIZIM TË LOJËRAVE TË FATIT F. 2

MUSTAFA: PSE TË MOS PUNOHET TË DIELËN? F. 8

EULEX-i E PËRMBYLL TRAJNIMIN PËR REAGIMET E PARA NË RASTET E DHUNËS NË FAMILJE PËR ZYRTARËT E POLICISË F. 7



## EKONOMI



NIS CIKLI I PARË I SEMINAREVE ME TATIMPAGUES PËR VITIN 2020 F. 9

IBRAHIM XHAKA EMËROHET USHTRUES DETYRE I DREJTORIT TË DOGANËS F. 8

## SPORT

PRISHTINA KËRKON PIKËT MAKSIMALE NË DRENICË F. 20

**Thaçi: Shaban Polluzha ishte frymëzues për shumë breza në përpjekjet për liri e pavarësi** | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: Po përgatis padinë për ministren e Drejtësisë

TIRANË, 21 SHKURT – Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta deklaroi të premten se do të depozitonte kallëzim penal ndaj ministres së Drejtësisë Etilda Gjonaj për botimin në fletoren zyrtare të një vendimi të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. “Ministrja e Drejtësisë duke urdhëruar sekretarin e përgjithshëm të dërgonte për botim në Fletoren Zyrtare, një vendim të KED-së ka shkelur në mënyrë flagrante Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së botimeve zyrtare”, si dhe Ligjin “Për Organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”,

deklaroi presidenti Meta. Rasti në fjalë i përket botimit më 9 nëntor 2019 të vendimit që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kishte marrë në muajin shtator, për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Botimi u konsiderua në atë kohë nga shumica, si një akt që e quante automatikisht të zgjedhur kandidaten Arta Vorpsi, por që për presidentin Ilir Meta përbënte një veprim që synonte të merrte një kompetencë që i takonte atij, ka njoftuar voa. Edhe të enjten në mbrëmje Meta dhe këshilltari i tij

juridik, treguan se vendimet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk hyjnë në kategorinë e akteve që botohen në Fletoren Zyrtare dhe se urdhri i lëshuar nga sekretari i Ministrisë së Drejtësisë ishte sipas tyre i paligjshëm, pasi autorizimin për botim e jep organi që e lëshon aktin. Nga ana tjetër ata vunë në dukje se urdhri për botim, është dhënë përpara se parlamenti të drejtohej ministrisë, me një kërkesë të tillë.

Meta tha të premten se ministrja Gjonaj kishte kryer disa vepra penale, nga “shpërdorim i detyrës” tek “ushtrim i



ndikimit të paligjshëm” e “falsifikim” dhe i kërkoi asaj dorëheqjen përpara se ai të depozitonte kallëzimin në Prokurorinë e posaçme antikorruption.

Nga ana e saj Gjonaj e cilësoi kallëzimin “një marrëzi të radhës nga ana e presidentit” dhe

se ishte e gatshme të përgjigjej ligjërisht, duke deklaruar se nuk ka ndërmend të dorëhiqet. Gjonaj megjithatë nuk dha shpjegime nëse urdhri nga ana e Ministrisë që ajo drejton për botimin e vendimit të KED-së është apo jo në përputhje me ligjin.

## Zaevi: Për herë të parë pres koalicion parazgjedhor me partitë shqiptare

Lideri i LSDM-së, Zoran Zaevi tha të premten se pret të gjejë forcë që për herë të parë të bëjmë koalicion parazgjedhor me parti nga blloku shqiptar, meqë po flasim për vlera, programe dhe diçka që mund të na lidhë



SHKUP, 21 SHKURT -Kryetari i Lidhjes Social Demokrate të Maqedonisë (LSDM) Zoran Zaevi, të premten paralajmëroi përparësi të partisë së tij në lidhje me marrëveshje për koalicion parazgjedhor me të gjitha partitë e tjera, sidomos me ato shqiptare.

Në mesin e funksionarëve të lartë të LSDM-së, por edhe Lëvizjes Besa dhe PDSH-së flitet për një koalicion të mundshëm të këtyre partive për zgjedhjet e 12 prillit.

Edhe pse nuk ka asgjë zyrtare, asnjëri nga kryetarët e partive nuk e kanë hedhur poshtë këtë mundësi, ka njoftuar zhurnal.

“Pres të gjejë forcë që për herë të parë të bëjmë koalicion parazgjedhor me parti nga blloku shqiptar. Koalicionet do të jenë përmbajtësore dhe më të gjera, ndërsa kjo nuk do të jetë më vonë se 9 marsi, kur është caktuar edhe kongresi i LSDM-së. Kjo na jep të drejtë të jemi favorit për zgjedhjet. Personalisht jam i kënaqur nga

bisedimet, pasi flasim për vlera, programe dhe diçka që mund të na lidhë, si dhe për marrjen e përgjegjësisë edhe në pushtetin ekzekutiv edhe në atë ligjvënës”, tha Zaevi.

Ndërsa në lidhje me listat e kandidatëve, Zaevi tha se ka përfunduar propozimi i kandidatëve të mundshëm.

Në anën tjetër, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) nuk ka komentuar koalicionin e mundshëm parazgjedhor mes LSDM-së, Besës dhe PDSH-së. Përderisa kreu i kësaj partie tha, me ironi tha se s’di asgjë për këtë, zëdhënësi Bujar Osmani tha se e rëndësishme është që Qeveria, pas zgjedhjeve të formohet me partinë fituese.

“Ah, nuk shoh kurrëgjë unë në këtë bashkëpunim, se s’di kurrëgjë. Nuk di”, tha lideri i BDI-së, Ali Ahmeti.

“Sistemi, pas Marrëveshjes së Ohrit nuk njeh përfaqësim tjetër përveç të atyre që e përfaqësojnë vullnetin e

qytetarëve. Nëse fitojnë ato parti, kuptohet se ato do të jenë në Qeveri. Ai që do të fitojë te shqiptarët, ai do t’i përfaqësojë shqiptarët në Qeveri. Këtë çështje, për fat të keq ne e kemi kuptuar në

mënyrën më të keqe të mundshme përmes përvojës. Periudha 2006-2008 na tregoi se shteti nuk mund të tolerojë një gjë të tillë edhe njëherë”, theksoi Bujar Osmani.

Duke iu referuar vetëm bllokut

politik shqiptar, Osmani në përgjigjen e tij anashkaloi faktin që BDI-ja është në koalicion parazgjedhor me LSDM-në, parti e cila kishte më pak vota se VMRO-DPMNE-ja, në zgjedhjet e vitit 2016.

## Policia shqiptare arreston 115 persona për organizim të lojërave të fatit

TIRANË, 21 SHKURT - Policia shqiptare tha të premten se ka ndërmarrë një aksion për mbylljen e aktiviteteve të paligjshme të lojërave të fatit.

Aksioni i policisë ndodhi një vit pasi autoritetet shqiptare ndaluan aktiviteteve të tilla.

Më shumë se 1.500 policë morën pjesë në operacionin që u zhvillua në Tiranë dhe shtatë qytete të tjera, derisa ndeshjet e futbollit të Ligës Evropiane u zhvilluan mbrëmjen e së enjtes.

Përmes një deklarate policia tha se arrestoi 115 persona

dhe 26 të tjerë po hetohen.

“Ata janë pronarë, menaxherë ose punonjës të këtyre bastoreve. Policia konfiskoi gjithashtu 140,000 euro dhe qindra kompjuterë dhe pajisje të tjera elektronike”, është thënë në njoftimin e policisë.

Në vitin 2018, Parlamenti i Shqipërisë votoi për heqjen e lojërave të fatit nga zonat e banuara.

Kazinotë tani lejohen vetëm në disa hotele të mëdha. Megjithatë, shumë aktivitete të tilla kanë vazhduar të funksionojnë në fshehtësi.



# 120 policë me probleme të rënda shëndetësore

Policia e Kosovës ka dhënë hollësi për gjendjen shëndetësore të zyrtarëve policorë. Sipas policisë, janë rreth 120 zyrtarë policorë me probleme shëndetësore, e prej tyre 20 janë me probleme shëndetësore të natyrës psikologjike, të cilët janë liruar nga arma zyrtare



**EPOKA  
ERE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 21 SHKURT** - Policia e Kosovës përmes një komunikate për media ka bërë me dije se 120 zyrtarë policorë janë me probleme të rënda shëndetësore, përfshirë personelin e uniformuar dhe atë civil. "Numër ky i cili mund të ndryshojë, të kategorizuara si raste të veçanta shëndetësore, për shkak të natyrës së rëndë të sëmundjes. Policia e Kosovës përmes Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore pranë PK-së i trajton këto raste me prioritet dhe përkrahja ndaj rasteve të veçanta shëndetësore ofrohet duke u bazuar në Procedurat Standarde të Operimit PSO-07 DSHSH-01. Referuar trajtimin mjekësor dhe rezultateve mbi gjendjen shëndetësore, nxirren rekomandimet për kërkesat e ndryshme mjekësore dhe psikologjike, për t'i caktuar punonjësit në: detyrë/punë më të lehtë, punë me orar të shkurtuar, lirim nga sforcimet fizike dhe pajisjet profesionale, përcaktim i aftësisë për punë, pushim si pasojë e lëndimit apo sëmundjes në detyrë, punë

vetëm në një ndërrim, seanca psikologjike, ekzaminime mjekësore dhe psikologjike etj", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Sipas kësaj komunikate, numri i zyrtarëve policorë të liruar nga arma zyrtare për arsye të problemeve shëndetësore të natyrës psikologjike janë gjithsej 20 zyrtarë, nga ky numër katër zyrtarë gjenden në pushim mjekësor të kategorizuar si rast i veçantë shëndetësor. "Në kuadër të policisë ekzaminimet mjekësore dhe testimi psikologjik periodik mbahet vetëm për Njësitë e Specializuara të PK-së (janë kryer 529 testime psikologjike), kurse njësitë e tjera nuk kanë ekzaminime periodike, por në rast nevojë, sipas kërkesave individuale, sipas indikacioneve dhe rekomandimeve nga eprorët e tyre, kryhen ekzaminimet", është theksuar në këtë komunikatë.

Po sipas Policisë së Kosovës, ekzaminime mjekësore kryhen edhe në klinikën e autorizuar nga PK-ja, ku në ekzaminimin e kryer për Njësitë e Specializuara nuk është evidentuar asnjë rast për

dështim nga aspekti psikik. "Pavarësisht se në procedurat aktuale të PK-së nuk kryhen testime psikologjike për zyrtarët policorë, psikologët e Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore në DPP kanë realizuar gjithsej (155) seanca psikologjike për 68 zyrtarë gjatë vitit 2019. Bazuar në kriteret dhe standardet mjekësore për testimet mjekësore periodike për Njësitë e Specializuara të Policisë së Kosovës (NJSO), janë realizuar kontrollet mjekësore ndaj zyrtarëve policorë të Njësiteve të Specializuara, ku 15 zyrtarë policorë nuk kanë përbushur kriteret për të qenë operativë në Njësinë Speciale Operative", është theksuar në këtë komunikatë

për media të policisë. Sipas komunikatës në fjalë, të gjithë këta zyrtarë policorë (15) janë të aftë për punë, për të kryer detyra dhe autorizimet policore në njësitë e ndryshme policore, por të njëjtët nuk i përbushin kriteret për të qenë operativë/operacionalë në Njësitet Speciale Operative, përdërisa në detyra dhe pozita të tjera mund të jenë edhe pjesë e Njësiteve Speciale Operative. "Andaj, bazuar në rezultatet zyrtare, vlerësohet se të gjithë këta (15) zyrtarë policorë janë të aftë për punë dhe për të kryer detyra sipas procedurave dhe autorizimeve policore në njësi të ndryshme policore dhe në NJSO, përjashtuar përbushjen e kriterëve për

të qenë operativë në NJSO, që do të thotë nuk angazhohen në operacione me rrezikshmëri", është theksuar në komunikatën për media të Policisë së Kosovës.

Diskutimi për gjendjen shëndetësore të zyrtarëve policorë vjen pas vrasjes së shumëfishtë që ndodhi të martën në Gjilan, ku zyrtarja policore, Valdete Bllaca, dyshohet se vrau prindërit, vëllezërit dhe pastaj veten. Vrasja dyshohet se është kryer me armën zyrtare. Sipas raportimeve në media, arma i ishte marrë Bllacës para disa muajve, ndonëse ende nuk dihet se si ka arritur që ta rimarrë nga stacioni.

Po ashtu, është raportuar se e njëjta disa muaj më herët ka pranuar tretman mjekësor.

## Ministrja e Jashtme e Xhamajkës thotë se nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës

**PRISHTINË, 21 SHKURT (ER)** - Ministrja e Jashtme e Xhamajkës, Kamina J. Smith, ka thënë se vendi i saj nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Në një postim në llogarinë e vet në "Twitter", Smith ka shpërndarë deklaratën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili e ka falënderuar Xhamajkën për njohje, por ajo ka thënë se vendi i saj nuk e ka ndërmarrë një hap të tillë. "Deri më sot Xhamajka nuk e ka njohur Kosovën", ka shkruar Smith. Të enjten presidenti Hashim Thaçi ka thënë se deri te njohja nga Xhamajka ka ardhur pas një lobimi shumëvjeçar. "Sapo u njoftova nga ambasadorja jonë (në



ShBA), Vlora Çitaku, se Xhamajka e ka njohur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran", ka shkruar Thaçi në "Twitter".

Të premtën Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës,

përmes një përgjigje me shkrim, ka bërë me dije se është njoftuar zyrtarisht të enjten në mbrëmje nga ambasadorja e Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku, për njohjen nga shteti i

Xhamajkës. "Të njëjtin njoftim ambasadorja e ka dërguar edhe në Zyrën e kryeministrit dhe të ministrit të Punëve të Jashtme. Presidenti këtë njoftim e ka bërë publik në profilin e vet në 'Twitter'. Për informacioneve të tjera, luteni t'i drejtoheni Ministrisë së Punëve të Jashtme", thuhet në përgjigjen e Zyrës së Informimit të Presidencës. Ndërsa ministri i Jashtëm i Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se situata është duke u shqyrtuar dhe se shumë shpejt do të ndërmarrë veprime në përputhje me përgjegjësitë e secilit. "Mbrëmë ambasadorja e Republikës së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, znj. Vlora Çitaku,

përmes postës elektronike e ka njoftuar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për njohjen nga Xhamajka. Në rrafshin profesional, informata zyrtare e një ambasadori/eje, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, konsiderohet si akt i mirëqenë dhe merret në konsideratë si e tillë. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me Ambasadën tonë në ShBA për ta sqaruar situatën e krijuar. Si ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pas shqyrtimit të situatës, shumë shpejt do të ndërmarrë veprime në përputhje me përgjegjësitë e secilit", ka shkruar Konjufca në llogarinë e vet në "Facebook".

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI BERISHA

# Taksën 100 për qind do ta mbrojmë



Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, beson se brenda këtij muaji do të thirret seanca e jashtëzakonshme parlamentare për ta kundërshtuar heqjen e taksës ndaj mallrave serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se deri më tani kanë arritur t'i mbledhin mbi 30 nënshkrime të deputetëve opozitarë për këtë çështje. Berisha ka vlerësuar se duhet të ketë konsensus të të gjitha partive politike për mbajtjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe. Deputeti i AAK-së ka vlerësuar se paralajmërimi i qeverisë për zëvendësim të takës me reciprocitet është mashtrim. "Ne do t'i përdorim të gjitha format demokratike për ta penguar vendimin e qeverisë për heqjen e taksës 100 ndaj produkteve serbe", ka thënë Berisha.

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, ka treguar se shumë shpejt do të arrihen 40 nënshkrime të deputetëve për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme parlamentare për ta kundërshtuar heqjen e taksës ndaj mallrave serbe. Ai ka deklaruar se deri më tani kanë arritur t'i mbledhin mbi 30 nënshkrime të deputetëve opozitarë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se ende qëndrojnë të gjitha arsyet që kanë çuar në vendosjen e taksës 100 për ndaj mallrave serbe. "Meqenëse këto arsye ende ekzistojnë, ne mendojmë se taksa duhet të vazhdojë të mbetet në fuqi. Ne përmes deputetëve të Kuvendit të Kosovës dëshirojmë ta

paralajmërojmë qeverinë që mos të gabojë në këtë drejtim. Mendoj se duhet të ketë një konsensus nacional për mbajtjen e taksës, si një mekanizëm i rëndësishëm deri në ardhjen e një marrëveshje kornizë që prejjudikon në të ardhmen njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Berisha.

Ai ka bërë me dije se kjo seancë e jashtëzakonshme parlamentare pritet të thirret brenda këtij muaji. "Deri më tani i kemi mbledhur mbi 30 nënshkrime. Besoj se shumë shpejt do t'i mbledhim edhe nënshkrimet e tjera të nevojshme. Në momentin që ta arrijmë shifrën e duhur, ne do ta dorëzojmë kërkesën tonë në Kuvend për ta thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme për këtë çështje", është shprehur deputeti i AAK-së.

Berisha ka vlerësuar se paralajmërimi i qeverisë për zëvendësimin e taksës me

reciprocitet është mashtrim. Sipas tij, Republika e Kosovës nuk ka mekanizma adekuatë për ta zbatuar parimin e reciprocitetit. "Vendosja e taksës për mallrat serbe ka qenë vendim, ka qenë akt dhe Kosova ka mekanizma për implementimin e një vendimi të tillë. Ndërsa parimi i reciprocitetit është një proces më i ngadalshëm, më i mundimshëm dhe Kosova nuk ka mekanizma adekuatë për zbatimin e parimit të reciprocitetit. Ne konsiderojmë se proklamimi se do të vendoset reciprociteti është vetëm një mashtrim ndaj popullatës", është shprehur ai.

Deputeti i AAK-së ka treguar se kjo parti do të përpiqet që së bashku me partitë e tjera opozitare të kenë qëndrime të koordinuara për këtë çështje. "Ne do të provojmë të kemi koordinim me subjektet e tjera opozitare për këtë çështje. Ne si Aleancë do t'i përdorim të gjitha

# me të gjitha format demokratike



pra procesi i mbledhjes së këtyre nënshkrimeve deri më tani po shkon mirë. Ajo që mund të them është se jemi afër mbledhjes së 40 nënshkrimeve, të cilat do ta mundësojnë thirrjen e një seance të jashtëzakonshme parlamentare.

**“Epoka e re”:** Deri më tani sa nënshkrime i keni mbledhur?

**Berisha:** Deri më tani i kemi mbledhur mbi 30 nënshkrime. Besoj se shumë shpejt do t'i mbledhim edhe nënshkrimet e tjera të nevojshme. Në momentin që ta arrijmë shifrën e duhur, do ta dorëzojmë kërkesën tonë në Kuvend për ta thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme për këtë çështje.

**“Epoka e re”:** Kjo nënkupton se keni arritur të merrni nënshkrime edhe nga partitë e tjera opozitare?

**Berisha:** Sigurisht. Në të kaluarën, në momentin e vendosjes së taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe, ka pasur një konsensus të plotë të të gjitha subjekteve politike. Pra, në atë kohë vendosjen e kësaj takse e kanë mbështetur partitë e pozitës dhe ato të opozitës. Ndërsa, tani ajo që dihet është se elementet bazike që e kanë determinuar vendosjen e taksës ende nuk janë hequr nga ana e Serbisë. Prandaj, besoj se një pjesë e konsiderueshme e deputetëve mendojnë se duhet të këtë diskutim në Kuvend lidhur me këtë çështje dhe se taksa është ende një mekanizëm i rëndësishëm për determinimin e bisedimeve me Serbinë deri në arrijtjen e njohjes së plotë të shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë.

**“Epoka e re”:** Po marrjen e nënshkrimeve të deputetëve nga partitë e koalicionit qeverisës, e keni synuar?

**Berisha:** Ne jemi të hapur për të gjithë deputetët që mendojnë se duhet të diskutohet kjo çështje në Kuvend, pa prejjudikuar përfundimin e diskutimeve të kësaj çështje në Kuvend. Deri tani, siç e thashë, kemi nënshkrimet e deputetëve të opozitës, por nuk përjashtohet mundësia që edhe ndonjë deputet që është nga pozita ta nënshkruajë kërkesën tonë për një seancë të jashtëzakonshme.

**“Epoka e re”:** A besoni se këtë seancë do të mund ta thirrni brenda muajit?

**Berisha:** Besoj se po. Ne tani po merremi edhe me diskutime të tjera lidhur me këtë çështje. Të hënën grupi parlamentar i AAK-së do ta organizojë një debat në Kuvendin e Kosovës, ku do të jenë pjesëmarrës edhe

biznesmenë të caktuar dhe deputetë, ku do të diskutohen përparësitë dhe përfitimet e deritashme të vendosjes së taksës për shumë biznese të Kosovës.

**“Epoka e re”:** Çka synoni të arrini përmes kësaj seance? Do të propozoni ndonjë rezolutë?

**Berisha:** Përmes asaj seance ne dëshirojmë ta ngrehim shqetësimin e njerëzve që përfaqësojnë nevojën e mbajtjes së kësaj takse, si një adut i rëndësishëm i Kosovës pasi që ende Serbia po vazhdon t'i përdorë të gjitha mjetet kundër Kosovës. Pra, ende qëndrojnë të gjitha arsyt politike, diplomatike dhe ekonomike që kanë çuar në vendosjen e taksës ndaj mallrave serbe. Meqenëse këto arsye ende ekzistojnë, ne mendojmë se taksa duhet të vazhdojë të mbetet në fuqi. Ne përmes deputetëve të Kuvendit të Kosovës dëshirojmë ta

paralajmërojmë qeverinë që mos të gabojë në këtë drejtim. Mendoj se duhet të ketë një konsensus nacional për mbajtjen e taksës, si një mekanizëm i rëndësishëm deri në ardhjen e një marrëveshje kornizë që prejjudikon në të ardhmen njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë.

**“Epoka e re”:** Siç e kemi parë, qeveria ka paralajmëruar zëvendësimin e taksës me reciprocitet. Pse e kundërshtoni vendosjen e parimit të reciprocitetit?

**Berisha:** Vendosja e taksës për mallrat serbe ka qenë vendim, ka qenë akt, dhe Kosova ka mekanizma për implementimin e një vendimi të tillë. Ndërsa parimi i reciprocitetit është një proces më i ngadalshëm, më i mundimshëm dhe Kosova nuk ka mekanizma adekuatë për zbatimin e parimit të reciprocitetit. Ne konsiderojmë

se proklamimi se do të vendoset reciprociteti është vetëm një mashtrim ndaj popullatës se po hiqet taksa dhe po zëvendësohet me këtë parim. Parimi i reciprocitetit do të ketë vështirësi të mëdha në zbatim.

**“Epoka e re”:** Nëse qeveria vendos ta zëvendësojë taksën me reciprocitet, si do të reagojë AAK-ja?

**Berisha:** Aleanca edhe opozita në përgjithësi besoj se do të koordinohen në përpjekjet e tyre në këtë drejtim. Ne do të provojmë të kemi koordinim me subjektet e tjera opozitare për këtë çështje. Ne si Aleancë do t'i përdorim të gjitha mekanizmat që i kemi për ta kundërshtuar këtë veprim të qeverisë, qoftë në Kuvend apo jashtë Kuvendit. Pra, ne do t'i përdorim të gjitha format demokratike për ta penguar vendimin e qeverisë për heqjen e taksës 100 ndaj produkteve serbe.



## Borelli zhvillon bisedë telefonike me Thaçin, Kurtin dhe Vuçiqin

**PRISHTINË, 21 SHKURT** - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka diskutuar me udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë lidhur me vendimin për ta emëruar një përfaqësues të posaçëm të BE-së për Dialogun dhe Ballkanin Perëndimor. “Përfaqësuesi i lartë nënvizoi se ky emërim pasqyron rëndësinë që BE-ja dhe ai personalisht i kushtojnë stabilizimit të rajonit dhe përparimit në rrugën drejt BE-së. Josep Borrell kujtoi se ai mbetet personalisht i angazhuar dhe i përkushtuar fuqimisht për ta mbështetur perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe për ta luajtur rolin e tij si lehtësues i dialogut Beograd - Prishtinë”, thuhet në një komunikatë nga zyra e

Borellit. Aty theksohet se gjatë bisedës telefonike me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministrin Albin Kurti, si dhe me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, përfaqësuesi i lartë i BE-së ka përditësuar diskutimin që ka pasur me udhëheqësit gjatë vizitës së tij në Prishtinë dhe Beograd në muajin janar. Në Beograd, Borell kishte thënë se BE-ja duhet të angazhohet më shumë në marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës. “Bashkimi Evropian duhet të emërojë një përfaqësues të posaçëm, i cili do të jetë shumë i angazhuar sepse unë nuk jam i sigurt se do të kem kohë të mjaftueshme për t'u angazhuar dhe për ta shtyrë dialogun përpara”, kishte thënë Borell pas

takimit me presidentin serb. Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë është ndërprerë në fund të vitit 2018 kur Kosova u ka vënë taksë 100 për qind importeve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Serbia e ka kushtëzuar rikthimin në dialog me heqjen e taksës, por Kosova, përkundër thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar, vazhdon ta mbajë në fuqi këtë masë. Në tetor të vitit të kaluar, presidenti amerikan Donald Trump ka emëruar ambasadorin e ShBA-së në Gjermani, Richard Grenell, të dërguar të posaçëm për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Me ndërmjetësimin e tij, Kosova dhe Serbia në javët e fundit kanë arritur dy marrëveshje: atë për hekurudhat dhe linjën ajrore Prishtinë - Beograd.

mekanizmat që i kemi për ta kundërshtuar këtë veprim të qeverisë, qoftë në Kuvend apo qoftë jashtë Kuvendit. Pra, ne do t'i përdorim të gjitha format demokratike për ta penguar vendimin e qeverisë për heqjen e taksës 100 ndaj produkteve serbe”, ka thënë Berisha.

**“Epoka e re”:** Z. Berisha, AAK-ja ka filluar mbledhjen e nënshkrimeve për një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit rreth taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe. Deri ku ka shkuar ky proces?

**Berisha:** Paralajmërimet e qeverisë për heqjen e taksës e kanë shqetësuar Aleancën dhe deputetët e saj. Si rezultat i saj jemi konsultuar që ta kemi një seancë të jashtëzakonshme parlamentare, ku do të diskutojmë lidhur me këtë çështje. Grupi Parlamentar i AAK-së është në proces të grumbullimit të nënshkrimeve,

# Thaçi: Shaban Polluzha ishte frymëzues për shumë breza në përpjekjet për liri e pavarësi

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 SHKURT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të premten ka marrë pjesë në Akademinë Përkujtimore për heroin Shaban Polluzha me rastin e 75-vjetorit të rënies së tij. Presidenti Thaçi ka thënë se sot kujtojmë dhe nderojmë me pietetin më të lartë dhe me përgjegjësinë më të lartë shtetërore Shaban Polluzhën dhe të gjithë bashkëluftëtarët e tij. “Është në nderin e kombit shqiptar rreshtimi në kampin antifashist në periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Rreshtim me vlerat demokratike dhe civilizuese. Radhitja në bllokun antifashist ishte shpresë se çështja e Kosovës do të zgjidhej, duke u bazuar në vullnetin politik të njerëzve të Kosovës. Ky vullnet ishte shprehur në Konferencën e Bujanit. Por, për fat të keq, ëndrra për çlirim dhe bashkim me Shqipërinë do të vritej nga kreu politik dhe ushtarak jugosllav. Kjo shpresë u vra edhe nga njerëzit e instaluar të Jugosllavisë në Kosovë”, ka deklaruar Thaçi.

Kreu i shtetit ka theksuar se Kosova dhe Drenica përjetuan terrorin dhe krimet më të tmershme të diktaturës komuniste në dimrin e vitit 1944-1945. “Periudha tremujore: dhjetor 1944, janar dhe shkurt 1945, ishte ndër periudhat

më tragjike, por edhe më heroike të popullit shqiptar në Kosovë. Një burrë Drenice, në moshën 74-vjeçare, kishte vendosur që ta ndajë fatin dhe udhëheq popullin e pambrojtur. Me paramendim dhe me strategji të qartë antishqiptare, kreu politik e ushtarak i Jugosllavisë, me gjithë aparatit shtetëror, filloi zbatimin e likuidimit të çdo atdhetari që kundërshtonte Jugosllavinë. Mijëra shtëpi u dogjën, mijëra civilë të paarmatosur u vranë dhe u masakruan. Më 8 shkurt 1945 kreu jugosllav e futi Kosovën nën masat e administrimit ushtarak, duke shpallur gjendjen e jashtëzakonshme”, ka thënë Thaçi. Ai ka shtuar se objekt i këtij administrimi u bë e tërë Kosova, me fokus të veçantë Drenica e Hasan Prishtinës dhe Azem e Shotë Galicës. “Synim i sulmit dhe goditjes u bë Drenica e komandantit Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica. Ai në krye të një numri të madh luftëtarësh vendosi që ta ndajë fatin me njerëzit e pambrojtur. Rezistenca u shua me gjak. Pas shuarjes së kryengritjes së Shaban Polluzhës, Kosova dhunshëm u aneksua nga Serbia në korrik të vitit 1945 në mbledhjen e Prizrenit. Ky krim do të mbahej gjatë i heshtur”, u shpreh ai.

Thaçi ka thënë se zona ku ndodhi kryengritja më e madhe antikomuniste pas luftës së Dytë



Botërore u diskriminua për pesë dekada me radhë. “U diskriminua me moszhvillim, me izolim, me injorim nga të gjitha pushtetet që u instaluan në atë kohë, ai jugosllav dhe ai i instaluar në Kosovë. Emri i komandantit Shaban Polluzha u ndalua zyrtarisht, por asnjëherë nga mendjet e ndritura dhe zemrat e pastra atdhetare në Kosovë. Historia ndërroi rrjedhën dhe nga një figurë e ndaluar, Shaban Polluzha sot zë vendin e duhur në historinë moderne të Kosovës”, ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se ai qëndroi në anën e popullit në të gjitha periudhat e historisë. “Ai mbrojti popullatën boshnjake nga sulmet çetnike në Kolashin dhe Novi Pazar, dhe ende në kujtesën e tyre çmohet si hero. Në periudhën e

sundimit turk, pastaj serb, bullgar, italian dhe gjerman, Shaban Polluzha mbrojti interesat kombëtare të Kosovës. Sado në kushte jo të favorshme historike, me luftën e tij kundër aspiratave shoviniste dhe shkombëtarizuese të komunizmit jugosllav, Shaban Polluzha u bë frymëzues për breza të tërë që u angazhuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”, u shpreh Thaçi.

I pari i vendit ka theksuar se pa luftën e Shaban Polluzhës, Mehmet Gradicës dhe gjithë bashkëluftëtarëve të tyre nga Drenica dhe gjitha hapësirat shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj nuk do të ndodhnin as rezistencat e mëvonshme të Lëvizjes Kombëtare të Kosovës, si Lëvizja për Liri, Pavarësi e Bashkim e

simbolit të rezistencës Adem Demaçi, demonstratat e vitit 68 dhe 81 për republikë dhe pavarësi, as grevat e minatorëve dhe nuk do të ndodhte as ky progres i Kosovës e nuk do të lindte as Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si dhe nuk do të ndodhte fare liria dhe pavarësia e Kosovës. “Çdoherë me përlësi do ta kujtojmë jetën, veprën dhe luftën e komandantit Shaban Polluzha, Mehmet Gradicës dhe gjithë bashkëluftëtarëve ndër breza që dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”, ka thënë Thaçi. Në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese, Presidenti i Republikës së Kosovës sot ndau urdhrin “Hero i Kosovës” për komandantin Shaban Polluzha.

## Theksohet rëndësia e projektit ‘ALLED 2’ për bashkëpunim me bizneset



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka pritur të premten në takim udhëheqësit e projektit “Harmonizimi i arsimit dhe aftësisë me nevojat e tregut të punës - ALLED 2”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim dhe ka për qëllim harmonizimin e arsimit dhe aftësisë me kërkesat e tregut të punës.

Në takim u theksua rëndësia e arsimit dhe aftësisë profesionale dhe mundësitë që po i krijon projekti “ALLED 2” duke i mbështetur institucionet arsimore për të krijuar bashkëpunim me bizneset dhe në këtë mënyrë edhe lidhjen me tregun e punës.

Ministrja Bajrami falënderoi udhëheqësit e “ALLED 2” për punën që po bëjnë përmes këtij projekti shumë të rëndësishëm për zhvillimin e arsimit dhe të

aftësisë profesionale, i cili i ndihmon të rinjtë tanë të jenë të përgatitur dhe kompetentë për tregun e punës.

Udhëheqësja e projektit, Efka Heder, e informoi ministren Bajrami më hollësisht për projektin dhe fushat ku është i koncentruar ky projekt, ndërsa theksoi gatishmërinë për t'i mbështetur politikatat që kanë për synim ngritjen e cilësisë në arsim, veçanërisht në arsimin dhe aftësimin profesional.

## Kurti emëron këshilltar të jashtëm politik Durim Berishën

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar të premten Durim Berishën këshilltar të jashtëm politik. “Durimi bartë titullin doktor shkence në fushën e Juridikut, me profil në Ligjin Kushtetues, Kushtetues Krahasues, Kushtetues të

Drejtësisë dhe Teorisë pranë Heinrich Heine University në Disseldorf të Gjermanisë. Ai ka një përvojë pune të zhvilluar si në ligjërime e akademi ashtu edhe në disa prej institucioneve të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare që merren me këshilla ligjore dhe sundim të ligjit. Kryeministri Kurti i

uroi z. Berisha suksese në detyrën e tij të re dhe shprehu bindjen se përvoja dhe ekspertiza e tij do të jenë një ndihmesë e madhe për punët që e presin ekzekutivin drejt shtetndërtimit demokratik dhe sundimit të ligjit në vend”, është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.



# EULEX-i e përmbyll trajnimin për reagimet e para në rastet e dhunës në familje për zyrtarët e policisë

Ky trajnim, mbajtur nga ekspertët e EULEX-it, Roland Burgsteiner dhe Magdalena Trojca, kishte për synim që t'u mundësojë zyrtarëve policorë të vijës së parë që t'i detektojnë me kohë rastet e dhunës në familje, ta standardizojnë reagimin e parë të Policisë së Kosovës ndaj këtyre rasteve dhe të krijohet një mjedis më i sigurt për të mbijetuarit duke e siguruar qasjen e bazuar në viktimën



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 JANAR - Prej datës 18 deri 20 shkurt 2020 në Prishtinë është mbajtur një trajnim i specializuar për reagimet e para të standardizuara dhe efektive në rastet e dhunës në familje për rreth 100 zyrtarë policorë të vijës së parë dhe hetues të dhunës në familje.

Ky trajnim, mbajtur nga ekspertët e EULEX-it, Roland Burgsteiner dhe Magdalena Trojca, kishte për synim që t'u mundësojë zyrtarëve policorë të vijës së parë që t'i detektojnë me kohë rastet e dhunës në familje, ta standardizojnë reagimin e parë të Policisë së Kosovës ndaj këtyre rasteve dhe të krijohet një mjedis më i sigurt për të mbijetuarit duke e siguruar qasjen e bazuar në viktimën.

Në fokus të këtij trajnimi ishte përmirësimi i aftësive dhe efektivitetit të reaguesve të parë në rastet e dhunës në familje në mënyrë që të sigurohen prova më të mira në vendin e ngjarjes dhe të përmirësohet cilësia dhe numri i hetimeve të suksesshme, si dhe krejt në fund të bëhet ndjekja penale dhe

grykimi i këtyre rasteve. Shefi i EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark, ka theksuar se korniza ligjore dhe politike e Kosovës për dhunën në familje është e avancuar. Ai ka shtuar se zbatimi aktual i ligjeve dhe strategjive mund të jetë sfidues. "Penalizimi i dhunës në familje në Kodin e ri Penal të Kosovës të miratuar vitin e kaluar është një moment i rëndësishëm. Ndërsa Strategjia Kombëtare 2016-2020 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ishte një element tjetër kryesor në arkitekturën e përgjithshme për luftimin e dhunës në familje. Shpresoj se Strategjia e re dhe Plani i Veprimit për pesë vjetët e ardhshëm, si dhe Ligji i ndryshuar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i cili tani është në pritje të miratimit, mund të miratohen sa më shpejt të jetë e mundur nga Qeveria e re e Kosovës", ka thënë ai.

Majori Ramadan Ahmeti, zëvendës-shef i policisë në Komunitet, vuri në dukje se ligjet e Kosovës janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, por zyrtarët policorë në vijën e parë të frontit

duhet t'i rrisin aftësitë e tyre për t'i trajtuar në mënyrë efektive çështjet e dhunës në familje. "Puna e reaguesve të parë mund të kontribuojë në rritjen e nivelit të besimit në Policinë e Kosovës. Kur një zyrtar është i trajnuar, me përvojë dhe profesional, të mbijetuarit do t'u afrohen atyre dhe do të komunikojnë me ta më lehtë. Ne duhet t'i identifikojmë mangësitë dhe t'i adresojmë ato në mënyrën e duhu ashtu që të jemi aty për të mbijetuarit dhe të shërbejmë si një shembull i shkëlqyeshëm për shoqërinë. Prioritet është

respektimi i ligjit. Për këtë nuk ka alternativë tjetër", ka pohuar Ahmeti.

Shefja e Njësisë së Trajnimit në Policinë e Kosovës, nënkolonel Zylfije Krasniqi, ka thënë se Policia e Kosovës duhet të marrë mbështetje të mëtutjeshme për reaguesit e parë në rastet e dhunës në familje. "Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të na ofrohen dhe të marrim pjesë në trajnime shtesë të specializuara si dhe ekspertizë të BE-së për reaguesit e parë", ka thënë Krasniqi.

Ky trajnim është pjesë e punës

së EULEX-it për ta përmirësuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në lidhje me rastet e dhunës në familje midis të gjitha palëve të interesuara dhe ofruesve të shërbimeve. Në bazë të mandatit aktual të tij, EULEX-i e ka shndërruar dhunën në baza gjinore në një fushë tematike specifike në kuadër të funksioneve të tij të monitorimit, me qëllim që ta mbështesë zbatimin e ligjit përmes gjetjeve dhe rekomandimeve specifike dhe ta ofrojë ndihmën përkatëse të synuar.

## Themelohen tri departamente të reja në Prokurorinë Speciale të Kosovës

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar të premtën, në takimin e rregullt, raportin vjetor të punës së KPK-së për vitin 2019, i cili është prezantuar nga kryesuesi Bahri Hyseni, me ç'rast ka shpalosur aspekte të veçanta dhe përmbajtjesore për punën njëvjeçare të Këshillit.

Gjithashtu, Këshilli ka miratuar themelimin e tri departamenteve të reja në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës:

Departamentin për Luftimin e Korrupsionit, Departamentin për Krim të Organizuar dhe Krim Financiar dhe Departamentin Kundër Terrorizmit, të cilat i ka prezantuar kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi.

Nga ana tjetër, KPK-ja ka miratuar dy raporte periodike për periudhën korrik-shtator dhe tetor-dhjetor të vitit 2019, që hartohen në kuadër të raportimeve të rregullta për luftimin e krimeve ekonomike, të cilat i ka prezantuar koordinatori



Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu.

Po ashtu, Këshilli Prokurorial ka miratuar edhe kërkesën e kryeprokurorit të Shtetit për transferimin e tre prokurorëve, dy në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe një në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, si dhe ka marrë vendim për transferimin e një prokurori nga Prokuroria Themelore e Prishtinës në atë të Mitrovicës për një periudhë të caktuar.

## Bislimi pret në takim ambasadoren e Kroacisë, flasin për bashkëpunimin mes dy shteteve

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka pritur të premten në takim ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barisic, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe Kroacisë, si dhe planet në të ardhmen, veçanërisht në fushën e financave. Bislimi ka falënderuar ambasadoren e Kroacisë për angazhimin e shtetit të saj për përkrahjen e Kosovës në proceset integruuese evropiane si dhe ka shprehur gatishmërinë e tij dhe institucionit që drejton

për ta thelluar bashkëpunimin me Kroacinë sidomos në fushën e financave. Ai e ka njoftuar ambasadoren për prioritetet e qeverisë Kurti, me fokus të veçantë në projektet që pritet të përfshihen në buxhetin e vitit 2020.

Ndërsa ambasadorja e Kroacisë e uroi Bislimin për detyrën e re dhe ka shprehur gatishmërinë e shtetit të saj për bashkëpunim në fushat me interes për të dyja vendet. Ajo ka theksuar rëndësinë e fokusit të qeverisë Kurti në zhvillimin ekonomik të Kosovës, si një ndër parakushtet kryesore për një shtet stabil dhe funksional.



## Ministria e Bujqësisë do ta ketë prioritet sektorin e qumështit



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në politikat mbështetëse për bujqësinë do ta ketë prioritet edhe sektorin e qumështit, me qëllim të shtimit të prodhimit dhe cilësisë së prodhimeve të këtij sektori. Përkrahjen për këtë sektor e ka konfirmuar të premten ministri i MBPZhR-së, Besian Mustafa, gjatë takimit me kryetarin e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit, Milazim Berisha, me të cilin kanë diskutuar për të arriturat dhe sfidat në këtë sektor në vitet e fundit. Me këtë rast, ministri Mustafa ka premtuar se kjo shoqatë do të jetë partnere serioze për

ministrinë gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve mbështetëse për fermerët e këtij sektori.

Po ashtu, ai ka ritheksuar se mbështetja për këtë sektor do të jetë në vazhdimësi përmes investimeve dhe projekteve të ndryshme, që për qëllim kanë edhe arritjen e standardeve evropiane në këtë sektor. Ndërkaq, Milazim Berisha, kryetar i Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit, duke e urreuar ministrin për detyrën e re, e ka falënderuar atë për gatishmërinë e tij për bashkëpunimin me këtë shoqatë për ta avancuar edhe më tej sektorin e qumështit.

## Policia arreston tre persona të dyshuar për 'kontrabandim të mallrave'

FERIZAJ, 21 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit DHKEK, ka arrestuar tre persona të dyshuar, nën dyshimin për kryerjen e veprave penale 'kontrabandim të mallrave', nga neni 311 dhe 'dhënie e rryshfetit', nga neni 422 i KPK-së.

DHKEK-ja, Sektori për Hetimin e Korrupsionit, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Ferizaj kanë filluar hetimet që nga data 4 tetor 2019, duke zbatuar masa të veçanta hetimore, me qëllim të nxjerrjes së provave dhe dëshmimeve për të dyshuarit e përfshirë në veprat penale.

Pas grumbullimit të provave të



nevojshme, më 20 shkurt Policia e Kosovës ka realizuar operacionin policor, me ç'rast janë kapur në flagrancë tre persona të dyshuar duke kontrabanduar mallra. Me urdhër të Gjykatës Themelore Ferizaj janë kontrolluar vendbanimet e personave të dyshuar, ku janë gjetur dhe janë sekuestruar sasi e konsiderueshme e paketimeve të peshkut të ngrirë dhe mishit të derri, si dhe janë sekuestruar edhe dy automjetet me të cilat janë kontrabanduar mallrat. Ndaj të dyshuarve është zbatuar masa e ndalimit me vendim të prokurorit të Prokurorisë Themelore.



# Mustafa: Pse të mos punohet të dielën?

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka shtruar pyetje se kush ka bërë analiza dhe ka ardhur në përfundim se mbyllja e dyqaneve, shërbimeve, aktiviteteve ekonomike ditën e diel nëpër komuna është në interes të publikut, të punësimit dhe të zhvillimit ekonomik? "Se kjo siguron tetë orë punë në ditë dhe 40 orë në javë? Mendoj se askush, sepse vështirë është të bashkëjetojë koncepti i ekonomisë së lirë të tregut dhe i promovimit të sektorit privat si promotor i zhvillimit me

ndërhyrje arbitrare në treg nga disa komuna, duke e marrë rolin e rregullatorëve ekonomikë. Pse ditën e diel qytetarët e Kosovës mund të blejnë dhe të shërbehen në Shkup e në Tiranë, por jo në qytetin e tyre dhe nga bizneset e Kosovës. Pse të dielën paratë tona mund t'i shpenzojmë në vendet e tjera, por jo në Kosovë, dhe pse në këtë ditë turistët dhe vizitorët nuk mund të gjejnë shërbime në Kosovë?", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka pyetur se ku qëndron arsyeja që për një ditë në javë të ulet kërkesa agregate në treg të



ne, me efekt negativ në brutoproductin vendor dhe në punësim, dhe kjo kërkesë të zhvendoset jashtë Kosovës? "Kjo

është vështirë të argumentohet me mendje racionale, por arsyetohet shumë lehtë me diletantizëm. Prandaj shoh arsye

që Autoriteti i Konkurrencës t'i shqyrtojë vendimet e disa komunave për ta ndaluar punën ditën e diel, në pikëpamje të cenimit të konkurrencës së lirë dhe të ndikimit në sektorin privat. Do të ishte e rrugës që bizneset të vendosin për ditët që punojnë e nuk punojnë duke e respektuar ligjin dhe orët javore të punës", ka thënë ai.

Lideri i LDK-së ka pohuar se tendenca për rregullim administrativ të ekonomisë dhe të jetës së qytetarëve është recidiv i kohëve të kaluara, si e tillë shkakton deformim të sistemit ekonomik në vendin tonë.

## Nis cikli i parë i seminareve me tatimpagues për vitin 2020

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në bashkëpunim me Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF), ka nisur ciklin e parë të seminareve me tatimpagues për vitin 2020. Temat të cilat po prezantohen në këto seminare janë: Risitë në Administratën Tatimore të Kosovës; Aplikimi i ngarkesës së kundërt për TVSh në ndërtimtari; Deklarimi vjetor PD, CD dhe DO; Risitë sipas ligjit të ri për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Deri më tani seminarët janë mbajtur në Prizren, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë, ndërsa dje është mbajtur seminari me tatimpaguesit e regionit të Prishtinës, për të cilin interesimi i tatimpaguesve ishte i



jashtëzakonshëm, por interesim i njëjtë ka qenë edhe në të gjitha qendrat e tjera ku janë mbajtur seminarët.

Në seminar ishte edhe drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, i cili ka falënderuar tatimpaguesit për interesimin e

tyre për ta përcjellë seminarin, po ashtu drejtori Murtezaj ka theksuar se ATK-ja do të vazhdojë të punojë për avancimin e

shërbimeve ndaj tatimpaguesve, në mënyrë që t'u bëhet më e lehtë përbushja e detyrimeve tatimore.

Gjatë këtyre seminareve pjesëmarrësit parashtruan pyetje të ndryshme lidhur me temat e prezantuara si dhe pyetje të tjera lidhur me Legjislacionin Tatimor. Për të gjitha pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit janë ofruar përgjigje adekuate nga prezantuesit e temave në seminar. Në të gjitha seminarët e mbajtura deri më tani numri i pjesëmarrësve ishte mjaft i lartë, ku pjesëmarrës ishin: organizata biznesi, OJQ apo përfaqësues të tyre, përfaqësues të njësisve të përhershme, kontabilistë dhe qytetarë të interesuar.

Seminari me temat e lartpërmendura do të mbahet në ditët në vijim edhe në Gjilan dhe Pejë.

## Shoqata e Naftëtarëve me letër për Kurtin, kërkon rregullimin e tregut



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Shoqata e Naftëtarëve të Kosovës i ka dërguar një letër kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në të cilën ka parashtruar disa kërkesa. Ajo kërkon që të ketë kriteret për ndërtimin e pikave të karburantit sipas standardeve të BE-së. "Ju njoftojmë se Shoqata e Naftëtarëve ka kërkuar që të ketë

kriteret për ndërtimin e pikave të karburantit sipas standardeve të BE-së dhe kategorikisht kemi qenë kundër ndërtimit të pikave të reja të karburantit, por kërkesa jonë ka hasur në vesh të shurdhër deri më tani. Një prej standardeve të BE-së është distanca në mes të pikave të karburantit, në rrugë lokale-komunale prej 5 deri në 10 km,

rrugë magjistrale prej 10 deri në 15 km si dhe në autostrada prej 20 deri në 25 km. Andaj, ne kërkojmë nga ju që të merrni masa sa ma shpejt lidhur me këtë çështje shumë të ndjeshme pasi që jemi shteti më i vogël në botë, por me më së shumti pika karburanti", thuhet në letërën e Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës.

## Ibrahim Xhaka emërohet ushtrues detyre i drejtorit të Doganës

Prishtinë, 21 shkurt (ER) - Ibrahim Xhaka është emëruar ushtrues detyre i drejtorit të Doganës së

Kosovës. "Në Drejtorinë e Doganës është bërë pranim-dorëzimi i detyrës së drejtorit të

Përgjithshëm nga Bahri Berisha tek Ibrahim Xhaka, i emëruar nga kryeministri ushtrues detyre i

drejtorit të përgjithshëm", është bërë me dije në njoftimin e Doganës së Kosovës.



## Mbështetja dhe ndihma për komunat, prioritet i MAPL-së

PRISHTINË 21 SHKURT (ER) - Ministria e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Emilija Rexhepi, ka pritur sot në zyrën e vet kryetarin e Komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasniq, me të cilin kanë diskutuar për sfidat dhe gjendjen me të cilën po përballet komuna e Mamushës. Në bashkëbisedim

me ministren, kryetari Krasniq ka theksuar nevojën e ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes nga ana e MAPL-së. Ministria Rexhepi ka theksuar se brenda kompetencave të ministrisë, në të mirë të të gjithë qytetarëve, në këtë rast qytetarëve të Komunës së Mamushës, do të gjejë një mënyrë për të ndihmuar këtë

qeverisje lokale, me ç'rast aktiviteti i saj i parë do të jetë vizita e kësaj komune me shumicë turke. Gjithashtu, në përfundim të takimit ministria Rexhepi ka theksuar edhe një herë se MAPL-ja është gjithnjë e gatshme si për Komunën e Mamushës, po ashtu edhe për të gjitha Komunat e Kosovës.



## Në dy shkolla të Mitrovicës ligjërohet për rolin e QPS-së në mbrojtjen e fëmijëve



MITROVICË, 21 SHKURT (ER) - Në vazhden e takimeve me nxënës të shkollave në Mitrovicë, drejtori i Qendrës për Punë Sociale (QPS), Gani Mustafa, së bashku me përfaqësuesin nga "Handikos", Edin Lahi, kanë mbajtur ligjëratë në shkollën "Hasan Prishtina" dhe gjimnazin "Frang Bardhi" në lidhje me rolin e kësaj qendre në mbrojtjen e fëmijëve. Me këtë rast, drejtori i QPS-së, Gani Mustafa, ka informuar nxënësit për rëndësinë e sensibilizimit të qytetarëve mbi rolin e QPS-së,

në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë si dhe për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve relevante mbi parandalimin e dukurive negative të fëmijët. Ndërsa përfaqësuesi nga "Handikos", Edin Lahi, ka përmendur faktin se roli i Qendrës për Punë Sociale të shoqëria. përkundër që është shumë i gjerë, ajo është e njohur fatkeqësisht vetëm si ofrim i ndihmës materiale sociale, mirëpo përmes këtyre

ligjëratave do të bëhet vetëdijesimi i ofruesve të shërbimit në institucionet arsimore, por edhe të nxënësve mbi fushat e ndryshme të mbështetjes që ofron QPS-ja. Në fund drejtorët e shkollave në fjalë kanë falënderuar iniciatorët e këtij projekti, duke i vlerësuar të nevojshme ligjëratat e tilla përmes të cilave mund të rritet vetëdija edhe për raportim dhe ofrim të shërbimeve të personat në nevojë, duke e potencuar rritjen e bashkëpunimit mes shkollës dhe QPS-së.

## Komuna e Kamenicës shqipton 20 gjoba për mosrespektim të Ligjit për duhanin



KAMENICË, 21 SHKURT (ER) - Komuna e Kamenicës ka bërë me dije se Inspektorati Komunal Sanitar ka shqiptuar 20 gjoba për lokalet në të cilat nuk është respektuar Ligji për duhanin. Kjo komunë ka theksuar se për personat fizikë janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 50 eurove, ndërsa për operatorët ekonomikë 500 euro. "Inspektorati Komunal

Sanitar në vazhden e zbatimit të Ligjit për duhan gjatë ditës së djeshme ka inspektuar të gjitha lokalet pa dallim në të cilat shërbehet ushqim. Të gjitha restorantet e qytetit dhe jashtë tij janë inspektuar, me ç'rast janë shqiptuar afër 20 gjoba, sipas Ligjit për pirjen e duhanit. Gjobat për personat fizikë janë shqiptuar në vlerë prej 50 eurosh, ndërsa për

personat përgjegjës të operatorëve janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 500 eurosh. Aksioni i Inspektorëve Komunalë Sanitar do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, duke përfshirë edhe kafiteritë dhe objektet e tjera publike. Lusim qytetarët për bashkëpunim dhe mirëkuptim!", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

## Komuna e Gjakovës investon 32 mijë euro në laboratorin stomatologjik të QKMF-së

GJAKOVË, 21 SHKURT (ER) - Komuna e Gjakovës ka bërë me dije se Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka siguruar së fundmi disa pajisje për laboratorin e stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), për blerjen e të cilave janë shfrytëzuar mjetet nga investimet kapitale të kësaj drejtorie. "Laboratori është pajisur me makina dhe tavolina të punës, mikromotorë, pajisja e gips të sallës me inventar, karrige,

dollapë për dosje e të tjera. Në kuadër të këtij investimi parashihen të vijnë edhe katër karrige stomatologjike. Investimi nga ana e DShMS-së e kap vlerën e rreth 32 000 euro, pasi që në këtë laborator nuk është investuar që 40 vjet", ka njoftuar Komuna e Gjakovës. Sipas këtij njoftimi, ushtruesi i detyrës së drejtorit të DShMS-së, Ferdinand Kolaj, ka thënë se kjo drejtori do t'i vazhdojë investimet e tilla për përmirësimin e kushteve për qytetarët e Gjakovës.



# Inovacion! Sa të duam e sa (s)na tremb!



**Majlinda BREGU**

Sapo futem në dhomën time të hotelit në Bruksel një tufë me aplikacione shfaqet në ekranin e TV-së. Përpiqem të gjej "TV app", që të dëgjoj ndonjë lajm, ndërkohë që vazhdoj kontrollon pa ndërprerje si robot, email-e, mesazhe, "WhatsApp", "Twitter", "Instagram", në të dy telefonat e mi.

Por ekrani i TV-së është si dhomë digjitale! Hajde gjeje ku dalin kanalet. Dhe unë dua vetëm të dëgjoj disa lajme në sfond, nuk po kërkoj lidhje me NASA-n! Më në fund kuptoj se mund ta lidh TV-në me telefonat kështu që gjithçka është në rregull. Hap CNN në telefon dhe shihet në TV.

Ja, kështu jemi bërë thujtë të gjithë. Siç thotë Yuval Harari që, fatkeqësisht, për mua, ka të drejtë: "Njerëzit janë vetëm një hap larg shndërrimit në makinë".

E pranoj. Mbase unë paragjykoj ç'po ndodh me teknologjinë sot, sepse më tremb fakti se si po na e ndryshon jetën revolucionin teknologjik. Dakord, krahasuar me rininë e sotme, unë jam thjesht një amatore entuziaste kur vjen puna për aftësi digjitale.

Ndoshta kam frikë se disa shpikje 'me duken çoroditëse'. Nëse revolucionin teknologjik digjital është trend global, ritmi

i përshtatjes dhe reagimet e politikave janë ende për mirë apo për keq kryesisht kombëtare ose rajonale.

Megjithatë, ende pyes veten se sa të aftë jemi ne, të këtij rajoni, të gjejmë atë 'gjilpërën në kashtë' në rezerva të pafundme të inovacionit dhe teknologjisë? E kam fjalën për gjilpërën e duhur, atë që mund të na ndihmojë të dallojmë çfarë po na ndreq a prish punë në këtë riformatim global të ekonomive, ndryshe

revolucionin i katërt industrial. Cili është inovacioni më i përshtatshëm për ne, që të mund të ndihmojë rajonin tonë të transformohet në mënyrë radikale? Që të ndryshojmë nga të ngathët- në rivalë të fortë dhe të përftojmë më shumë nga ky rend i ri teknologjisë?

Çfarë na duhet për të na nxjerrë nga gjendja pasive, opake, e të na bëjë të vrapojmë dyfish më shpejt në transformimin e tregut të punës, përshtatjen e politikave të arsimit e konkurrencës në mënyrë që shkollat dhe universitetet t'u ofrojnë brezave që vijnë aftësitë e nevojshme për të punuar në botën teknologjike?!

Më shumë se 300 vjet më parë Isaac Newton tha: "Të gjithë mund të rrinë në gjendje pushimi, ose lëvizin në vend në vijë të drejtë. Gjendja ndryshon vetëm të shtyjnë ca forca të tjera".

Atëherë, cila është 'forca' që mund ta shtyjë Ballkanin Perëndimor të 'zgjohet' dhe të ndryshojë rregullat e lojës?

Çfarë mund të kthejë avantazhin në anën tonë, përshpejtojë reformat dhe t'i japë një shtysë të re zhvillimit të rajonit dhe në të njëjtën kohë

të krijojë mundësi më të mira për qytetarët e t'i japë fund 'largimit të trurit' gjithnjë e në rritje?!

Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë ndër 10 vendet e para në botë me 'largimin më të lartë të trurit' në 2018-n 5.7 milionë njerëz kanë emigruar dhe janë larguar nga Ballkani Perëndimor në 5 vitet e fundit - e barabartë me 1/3 e popullsisë.

Dikur, rajoni ynë, ishte eksportues i dy kategorive kryesore: çeliku, alumini dhe produktet e tekstilit. Por jo sot. Jo më.

Sot, tregu është kthyer drejt pajisjeve elektrike, makinerive dhe mjeteve të transportit, të cilat janë kryesisht produkte të huaja të investimeve direkte që kërkojnë një shkallë më të madhe teknologjike dhe përpunimi të avancuar. Me një fjalë, inovacion - që do të thotë aplikim i zgjidhjeve më të mira që plotësojnë kërkesa të reja, nevoja të pa artikuluar më parë, ose nevoja ekzistuese të tregut.

Pra, kaq kërkuaka inovacioni? Më shumë investime në buxhetin e kërkimit dhe zhvillimit?!

Ballkani Perëndimor investon më pak se 1 për qind të PBB-së në inovacion dhe kërkim. Vetëm 30-40 për qind e bizneseve përtërihen dhe shumica e tyre vetë-financohen pa asnjë mbështetje publike.

Në Ballkanin Perëndimor duhet ta gjejmë ende formulën se çfarë mund të rinovojmë, si ta përfshijmë inovacionin e teknologjinë në treg dhe si ta përdorim për të ndryshuar nivelin e investimeve në

ekonomi.

Inovacioni përhapet më shpejt në një treg të unifikuar dhe e bën atë më konkurrues në arenën botërore. Me hapa të vogla gjatë 2019-s, vetëm 9 për qind e kompanive në Ballkanin Perëndimor kanë bashkëpunuar me universitete për kërkim dhe zhvillim ose kanë bashkëpunuar për ide të reja tekno që mund të sjellin në treg produkte ose shërbime të reja. (Barometri Ballkanik në proces 2020 - të dhëna të botuara vetëm për këtë artikull) Në tri vitet e fundit, 26 për qind e bizneseve deklarojnë se kanë sjellë produkte të reja në tregun rajonal, 4 për qind ishin ide të reja edhe për tregun evropian dhe vetëm 3 për qind ishin risi në rang global. Shumica dërrmuese ose 79 për qind pohojnë se ia kanë dalë me forcat e tyre, dhe vetëm 4 për qind thonë se kanë pasur mbështetje financiare publike ose të donatorëve.

Pak rëndësi kanë frikësimet e mia e të ngjashmeve të mi. Teknologjia dhe inovacioni udhëheq rritjen ekonomike dhe ndihmuar bizneset të prodhojnë më shumë me më pak, ose duke gjeneruar prodhim më të madh me të njëjtin input. Krijon biznese të reja dhe është burimi themelor i rritjes në biznes dhe industri. Shfrytëzimi i suksesshëm i ideve të reja është thelbësor që një biznes të jetë në gjendje të përmirësojë proceset e veta, të sjellë produkte dhe shërbime të reja dhe të përmirësuara në treg, të rritë efikasitetin dhe, më e rëndësishmja, të përmirësojë përfitimin. Inovacioni rrit aftësinë e shoqërisë për të vepruar, për të zgjidhur

problemet kolektive në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase.

Energjia elektrike e ndryshoi shoqërinë e shekullit 19, ndryshoi edhe mënyrën e të bërit luftë. Teknologjia po riformatim ekonominë globale dita-ditës. Inovacioni për produktet, inovacioni i procesit, inovacioni i marketingut dhe inovacioni menaxherial janë ato që përbëjnë bazën e konkurrencës. E reja dhe inovacioni lindin si do ide prej dëshirës, por dhe frikës sa do të mbijetojë, por nëse nuk rrezikojmë sot, a do të mund ta përftojmë nesër nga gjithë këto ndryshime që po sjell teknologjia?!

Është koha për mendje të bukura!

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Forumi Ekonomik Botëror (WEF) janë bashkuar për t'i dhënë udhë Përshpejtimin të konkurrencës dhe inovacionit në Ballkanin Perëndimor - i pari i këtij lloji në rajon dhe botë, që do të prezantua më 21 shkurt, në Tiranë dhe duke shpresuar të jemi gati në të gjithë rajonin në fund të vitit.

A ka të panjohura?

Mbase, disa si puna ime mund t'i druhen kësaj kohe kur nuk flitet më për pengesa filozofike, madje dhe idetë janë gati monolitike, por jetojmë mes algoritmeve që mund të na drejtojnë mendimet e të na lexojnë emocionet. Megjithatë pa konflikt, rrahje mendimesh, frika e debate, s'lindin ide të reja.

Gjithsesi më mirë me kohën sesa harruar edhe prej saj!

**(Autorja është sekretare e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal)**

## Nga 1 marsi në Skenderaj e diela do të jetë pushim për bizneset

**SKENDERAJ, 21 SHKURT (ER)** - Komuna e Skenderajt, me qëllim të zbatimit të Ligjit të Punës, mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, nga data 1 mars do të fillojë së zbatuari Rregulloren Komunale mbi orarin e punës në fushën e tregtisë, hotelierisë, zejtarisë dhe shërbimeve të tjera.

Në bazë të kësaj rregulloreje komunale e diela do të jetë ditë pushimi për shumicën e subjekteve afariste në territorin e kësaj komune.

Përjashtim bëjnë dyqanet ushqimore të cilave u lejohet të

punojnë edhe të dielave deri në orën 11:00, kafiteritë, restorantet, furrat e bukës, sallonet e ondulimit si dhe pikat e shitjes së derivateve të naftës të cilat do të vazhdojnë të punojnë me orar të rregullt siç kanë punuar deri më tani. Me këtë rast, Komuna e Skenderajt, Inspektorati Komunal, kërkon mirëkuptim nga të gjitha bizneset dhe kërkon nga ta që kjo rregullore të respektohet përndryshe, për mosrespektimin e kësaj rregulloreje, pason gjyq sipas legjislacionit në fuqi.



## Pompeo: Marrëveshja e paqes me talibanët pritet të nënshkruhet më 29 shkurt

WASHINGTON, 21 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo tha se marrëveshja e paqes mes Shteteve të Bashkuara dhe talibanëve në Afganistan, pritet të nënshkruhet më 29 shkurt, me kusht që një "ulje e dhunës" që hyn në fuqi më 22 shkurt të dëshmohet e suksesshme. "ShBA-ja dhe talibanët janë angazhuar në bisedime për të lehtësuar një zgjidhje politike, për t'i dhënë fund konfliktit në Afganistan si dhe për të zvogëluar praninë e ShBA-së në rajon", thuhet në deklaratën e Pompeo.

Marrëveshja vjen pas më shumë se një viti bisedimesh midis përfaqësuesve të talibanëve dhe atyre të Shteteve Bashkuara. Qeveria afgane, nuk ishte pjesë e negociatave. Në dhjetor të vitit 2018, talibanët njoftuan se ata do të takohen me zyrtarë amerikanë në përpjekje për të gjetur një "udhërrëfyes për paqen". Por, militantët vazhduan të refuzojnë të zhvillojnë bisedime zyrtare me qeverinë afgane, duke i cilësuar ata si "kukulla" të Perëndimit.

Pas nëntë raundesh bisedimesh mes ShBA-së dhe talibanëve në Katar, të dyja palët dukeshin afër një marrëveshjeje. Negociatori i lartë i Uashingtonit njoftoi në shtator të vitit 2019, se SHBA-ja do të tërhiqte 5.400 trupa nga Afganistani brenda 20 javësh, si pjesë e një marrëveshjeje të rënë dakord "në parim" me militantët talibanë. Por, disa ditë më vonë, presidenti amerikan, Donald Trump, tha se bisedimet ishin "të vdekura", pasi grupi militant mori përgjegjësinë për



vrasjen e një ushtari amerikan. Forcat amerikane janë në Afganistan që prej pushtimit

më 2001, që kishte për qëllim rrëzimin e talibanëve nga pushteti.

## Pas paralajmërimeve për Rusinë, Trumpi shkarkoi kreun e Zbulimit Kombëtar

"Washington Post" dhe "New York Times" thanë të enjten se presidenti ishte i irrituar pasi mësoi për informimin e javës së kaluar për anëtarët e Komitetit të Zbulimit, i shqetësuar se zyrtarët kishin dhënë informacione që mund të përdoren kundër tij

WASHINGTON, 21 SHKURT - Mediet amerikane njoftojnë se presidenti amerikan Donald Trump mori vendimin për të larguar zyrtarin e tij më të lartë të shërbimeve të zbulimit, pas një seance të klasifikuar informimi të ligjvënësve për sigurinë e zgjedhjeve. "Washington Post" dhe "New York Times" thanë të enjten se presidenti ishte i irrituar pasi mësoi për informimin e javës së kaluar për anëtarët e Komitetit të Zbulimit, i shqetësuar se zyrtarët kishin dhënë informacione që mund të përdoren kundër tij. Presidenti Trump më pas e thirri drejtorin në detyrë të Sigurisë Kombëtare Joseph Maguire në zyrën e tij të nesërmen, kur përfundimisht vendosi ta zëvendësojë. "Ishte një zhveshje e Maguire", i tha një burim, duke folur në kushtet e anonimitetit, gazetës "The Washington Post". Kjo ishte katalizatori. Sipas "New York Times", zemërimi i presidentit u

nxit nga një vlerësim i njëjës prej ndihmësve të larta të Maguire, Shelby Pierson, e cila u tha ligjvënësve se Rusia ka qenë duke ndërhyrë në fushatën presidenciale amerikane për vitin 2020, duke synuar rizgjedhjen e tij. Zyrtarët pranë Zyrës së drejtorit të Inteligjencës Kombëtare dhe zyrës së saj të sigurisë zgjedhore nuk pranuan të komentojnë kur u kontaktuan nga "Zëri i Amerikës". Një kërkesë për koment drejtuar Shtëpisë së Bardhë gjithashtu nuk mori përgjigje, por reagimi nga ligjvënësit demokratë ka qenë i shpejtë. "Jam shumë i shqetësuar", tha kryetari i Komitetit të Sigurisë Kombëtare të Dhomës së Përfaqësuesve, Bennie Thompson në një deklaratë të enjten vonë. "Presidenti e vendos egon mbi vendin", shtoi ai. "Duke shkarkuar drejtorin në detyrë të zbulimit kombëtar, Maguire, sepse stafi i tij i dha Kongresit



konkluzionet e sinqerta të Komunitetit të Inteligjencës në lidhje me ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, presidenti nuk po refuzon vetëm të mbrohet kundër ndërhyrjeve të huaja, ai po e fton atë", tha ai. Marrëdhënia e ashpër midis Trump dhe agjencive të inteligjencës amerikane daton në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, kur komuniteti i inteligjencës konkludoi se, "Presidenti rus Vladimir Putin dhe Qeveria ruse aspiruan të

ndihmojnë shanset për t'u zgjedhur Trumpi president me çdo mundësi", kanë shkruar në një raport jo të klasifikuar të publikuar në vitin 2017, agjencitë kryesore të zbulimit amerikan. Këto përfundime u mbështetën nga një raport në prill 2019 nga këshilltari special Robert Mueller, i cili konstatoi se, "Qeveria ruse konkludoi se do të përfitonte nga një presidencë Trump dhe punoi për ta siguruar këtë rezultat". Por, presidenti Trump vazhdimisht ka mohuar çdo ndërhyrje ruse, duke iu referuar

mohimeve të Putinit. "Ai tha që nuk ndërhyri në zgjedhje", u tha Trumpi gazetarëve pas një bisede me Putinin në Vietnam. "Ai tha që nuk ndërhyri. Unë e pyeta përsëri. Nuk mund ta pyes pa fund", tha ai. Megjithatë, zyrtarët e inteligjencës amerikane kanë thënë, në mënyrë të përsëritur, se jo vetëm që Rusia ndërhyri në zgjedhjet e vitit 2016, por se e bëri këtë përsëri në 2018 dhe se do të ndërhynte gjithashtu në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020.

## Gjermania shton masat e sigurisë pas sulmeve në Hanau

BERLIN, 21 SHKURT - Gjermania do të vendosë forca shtesë policore për të mbrojtur xhamitë, stacionet hekurudhore, aeroportet dhe vendet e tjera të ndjeshme, për shkak të një kërcënimi "shumë të lartë" të elementeve të së djathtës, njoftuan zyrtarët. Ministri i Brendshëm gjerman,

Horst Seehofer, tha se ai kishte rënë dakord me udhëheqësit rajonalë, për masat e reja të sigurisë. "Kërcënimi i sigurisë nga ekstremizmi i krahut të djathtë, antisemitizmi dhe racizmi është shumë i lartë", tha ministri Seehofer. Të mërkurën, një ekstremist i

dysshuar i krahut të djathtë vrau nëntë vetë në dy bare në qytetin e Hanaut. I dyshuari më pas u gjet i vdekur në një apartament. Hetuesit janë duke e trajtuar sulmin si akt terrorizmi. Prokurorët thanë se sulmuesi i dyshuar, tani i vdekur, ishte "thelësisht racist".



# SIGMA

## VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:  
• **Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.  
Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.  
**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju**

### mirëpresim në zyrat e reja! NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:  
• **Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**


The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.  
We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajucceg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:  
• **Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.  
Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajucceg društva na gore navedenu novu adresu glavne



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)

Nekrolog

# VITI I VETMISË

*Me rastin e njëvjetorit të ndarjes nga jeta të Xhevahire (Demaj) Mujaj***H. MUJAJ**

Viti i vetmisë së madhe. Shumë të madhe. Një vit nga ndarja fizike. Vetëm fizike. Sepse, shenjtërisht e shpirtërisht, emocionalisht dhe etikisht je me ne: ditë e natë. Gjithmonë. Viti 2019 na bëri të sflitur, shqim të sflitur. Përherë të sharguar. Përgjërues. E shtunë, më 23 shkurt 2019, në orën 4.45. Në Spitalin e Pejës, në internistikë, në dhomën nr. 10. Me gjithë përkujdesjen e mjekëve, u nda nga mesi i të gjallëve bashkudhëtarja drejtuese e jetës sonë familjare, orientuesja e ngritjes dhe e lulëzimit të jetës - zonja Xhevahire (Demaj) Mujaj. Vegim i agimit më tronditës; vegim i një agimi të errët e lotues. Përsëritja e fundit me më të dashurën tonë. Qe përsëritje trishtuese. Shumë trishtuese. E përvajshme. U nda nga jeta lehtësisht: duke folur, flegmatike, pa asnjë pipëtimë. Në këtë mënyrë sythit e qeshur, që janë "dritare e shpirtit", pasi bënë lamtumirën e fundit, zunë dhe u mbyllën përgjithmonë. Personalitetin tënd e veçonin përbërësit më humanë të etikës si p.sh.: skofia e maturia, altruizmi e gjentiliteti, fisnikëria dhe emfatia, mikpritja e solidariteti etj. Këto cilësi formimi, nga të cilat morëm mësim dhe edukim, të shquanin prore. Të rritur e të orientuar në frymën e këtyre virtyteve të larta e të tjera të këtyra, patëm jetë të lumtur e të ndritur, vezulluese, plot galdim e hare, me mirosje e disponim; kështu na krijoje atmosferë ngazëluese e jehuese, sa artësuese, aq edhe mbresuese. Të gjitha këto na lanë të shtunën e 23 shkurtit 2019. Ditë shumë e pikëllueshme. Përjetësisht na bëri të pikëllueshëm; përherësisht shpirtërisht si të vetmuar, të përgjëruar e të heshtur. Sepse, vuajtja shpirtërore davarit edhe fjalët, të cilat sikur na kanë ikur bashkë me më të shndritshmen e më të madhërishten tonë. Ngado lëvizim, kudo që shikojmë, i shohim gjurmët e tua, bëmat e tua të arta; na bëhet sikur të shohim në hapësira të ndryshme të shtëpisë së madhe; na bëhet sikur na thërret zëri yt i këndshëm e përkëdhelës, të cilin

tanimë po përpiqemi vetëm ta imagjinojmë. Dy vjet e gjysmë patëm rrugëtim shërimi: brenda e jashtë shtetit. Pate mbikëqyrje të përhershme të mjekësisë sipërore; pate shoqërim e përkujdesje të vazhdueshme familjare: të gjithë viheshim në dispozicion e në pozicion veprimi për t'u gjetur pranë teje. Udhëtimet e gjata nuk të lodhnin; ato i kaloje gjithnjë e disponuar, e qeshur dhe e freskët. Ekspozimi i epiteteve të këtyra na bënte sikur shkonim në ndonjë shënim solemn. Terapitë e rënda triumfisht i tejkalove. Në këtë ecuri të gjatë mjekimi, bjeshkë e shkëmb qe: nuk të humbi as estetika e fytyrës; qëndrove vidë e rirë; vigane e rrezore; sutë kreshte; e admirueshme dhe e mahnitshme: ekstazë. Me gjithë përmirësimin e dukshëm, që e pritëm me shëndim e lumturi, sëmundja u kthye befasisht, me nxitim e rrëmbim. Edhe kur t'u ndal fryma e fundit, nuk u vele. Qemë të pandarë katërdhjetë e dy vjet; kudo bashkë: në rastet e

ndryshme solemne, në përrurime, në jetën private: në shëtitje, në det, në bjeshkë; në veprimtarinë zyrtare: në takime, në shënime përvjetorësh, në ceremoni të ndryshme akademike, shkencore, kulturore etj. Ndonëse në papraninë tënde fizike, po e kalojmë kohën duke i përsëritur fjalët e shprehjet e tua që përherë do t'i mbajmë në mendje dhe të cilat do të na shërbejnë si shtysa nxitëse e motivuese për arritje të reja; ato, fjalë e shprehje, u referoheshin mësimëve edukative të solidaritetit, të tolerancës e të durimit për t'i matur e vlerësuar me bindje fjalët para se të thuheshin kudo; për t'i zgjedhur fjalët që nuk vrasin askën, fjalë me të cilat hapen dyer të mbyllura, për të ndërtuar stilin etik dhe estetik të komunikimit me të cilin (stil) vihen e krijohen ndërlidhje emancipuese, civilizuese dhe ndjenja të miqësisë e të mirësisë edhe për të tjerët, stil që mbjell shend të

madh për të bimuar vepra të mëdha etj. Të premtojmë se do t'i kultivojmë e trupëzojmë me përkushtim të gjitha tiparet e sipërpërmendura të shpirtmadhësisë tënde, të cilat na i thoshe përditë. Ato (tipare) do t'i kemi si pikënisje frymëzimesh të thella për ta rirë e për ta shtrirë më tej brenda nesh e më gjerë veprimtarinë moralizuese, edukative, diturore, socio-kulturore etj. Tani po të shkruajmë se mungesa Jote na ka vënë në heshtje; askush nuk flet; nuk kemi fjalë të komunikojmë sepse ato (fjalët) paraqesin fizionominë e shpirtit të përgjëruar si brengë jona, hëpërhë e pakapërcyeshme. Madje, të njoftojmë se, fshehurazi nga njëri-tjetri, sidomos nga nipërit dhe mbesa e vogël-Etika, që të kërkon përditë, ditët e netët tona ndiqen nga malli e lotët për të parën e familjes, ikja e papritur e së cilës na la si të ngrirë: të mallëngjyer e të ngashëryer, të sharguar e të sflitur. Qe lexuesja

dhe vlerësuesja e parë e disa shkrimeve të mia (H. M.), sidomos e shkrimeve rreth zhvillimeve aktuale në vend. Ndonjëherë me të drejtë më jepje nga një kritikë përkitazi me ndërtimin e përdorimin e disa neologjizmave. Qe shumë kureshtarë për ecuritë risimtare në Kosovë, të cilat i komentonim së bashku dhe, më në fund, piqeshim në një vlerësim. As sëmundja e rëndë nuk t'i bori kategoritë e larta estetike që të dalluan tërë jetën: bukuria shpirtërore e bukuria fizike; e para zbukuron edhe të dytën-kishte shkruar filozofi i shquar L. A. Seneka. Edhe pse ndërrova jetë, asnjëra nga këto veti nuk t'u venit. E pabesueshme, por e vërtetë: edhe në arkivol të yjëzonte fytyra: art mahnitës e atraktiv i gërshtuar me shkëndijat më të ngrohta të përfaqimeve të fundit, të cilin (art të fytyrës), sa të jemi në jetë, do ta paraqyetojmë me të madh mall e me dashuri. Të bëftë shpirti dritë!

Me lektisje të përhershme!



# Dhjetë gjuhët më të vjetra në botë që fliten edhe sot

Gjuhët kanë qenë gjithmonë “fibra” e njerëzimit. Guri i themelit të shoqërisë njerëzore, dhe forca që i hapi rrugën qytetërimit. Pa të, shoqëritë nuk mund të zhvilloheshin siç janë zhvilluar. Ndaj gjuhët janë “testament” mbi nevojën e madhe të species tonë për të ecur përpara. Sigurisht që ato janë një forcë fluide, evoluojnë gjithmonë, në vërësi të kohës dhe ndikimeve të jashtme. Edhe sot, gjuhët zhduken dhe rishfaqen, në forma të reja dhe të ndryshme. Por cilat janë gjuhët më të vjetra në botë, që fliten ende sot?

## Gjuha baske

Gjuha Baske ose Euskara siç njihet nga folësit e saj, është vërtetë një gjuhë e mahnitshme dhe unike në Evropë. Ajo flitet sot në rajonin Bask në Spanjë nga rreth 750.000 folës amtare dhe rreth 1.185.000 folës të tjerë, që nuk e kanë gjuhën e tyre të origjinës. Rajoni Bask është shtëpia e popullit bask, një zonë që shtrihet midis kufirit mes Spanjës dhe Francës, e përqendruar rreth Gjirit të Biskajës. Gjuha baske nuk ka asnjë lidhje me gjuhët fqinje. Një teori interesante, e lidh baskishten me gjuhët e maleve të Kaukazit, siç janë gjuha çeçene dhe ajo gjeorgjiane, që janë gjithashtu unike.

## Gjuhët kartveliane

Banorët autoktonë të rajonit të Maleve të Kaukazit Jugor, gjuhët kartveliane janë padyshim ndër më të vjetrat në botë, dhe që fliten ende. Këtu futen gjuha gjeorgjiane, svan, zan, mingrelian dhe laz. Izolimi gjeografik i fiseve që jetonin këtu, lejoi zhvillimin e pashqetësuar të shoqërive unike, që më vonë do të sundonin rajonin. Gjuha gjeorgjiane, ka formën e saj më të hershme të shkruar që daton në vitin 430 Pas Krishtit. Por vetë gjuha, është sigurisht shumë më e vjetër. Kjo familje gjuhësore, nuk është e lidhur me asnjë tjetër në botë, dhe ka rreth 5.2 milionë folës në të gjithë botën. Gjuha tamile

Gjuha tamile është një pjesë e gjuhëve dravidiane, dhe flitet nga komuniteti etnik Tamil, që banon në pjesën më jugore të nënkontinentit Indian. Ajo është gjithashtu një nga gjuhët më të vjetra në botë që fliten ende sot.

Në shtetin indian Nadu, gjuha tamile është gjuha zyrtare. Ajo nuk ka asnjë lidhje “gjenetike” me gjuhën dominuese hindu në Indi. Ajo flitet nga rreth 75 milionë tamile, të shpërndarë në të gjithë botën. Forma e saj më e hershme e shkruar, daton në vitin 300 Para Krishtit.

## Gjuhët paleo-siberiane

Ato u përkasin fiseve të largëta të Siberisë dhe Lindjes së Largët në Rusi. Këtu përfshihen gjuhët ket, çukotko-kamçatkane, nivk dhe hukagir. Nga ana tjetër, ato

përbëhen nga shumë forma dhe dialekte rajonale. Është e sigurtë, që këto gjuhë i paraprijnë gjuhëve që janë sot dominuese në Siberinë e sotme, si gjuhët ruse, tunguze dhe turke. Këto fise nomade, nuk zhvilluan kurrë një sistem të shkruar të gjuhëve të tyre.

## Gjuha ainu

Është gjuha e komunitetit etnik Ainu në Japoninë Veriore, dhe që i papaprin popullit modern japonez, që u vendos në këto ishujt. Ainu është një gjuhë e izoluar, pa asnjë lidhje me japonishten. Ekzistojnë disa lidhje të vogla të saj me gjuhët paleo-siberiane. Njerëzit e komunitetit ainu dhe gjuha e tyre janë sot të rrezikuara, teksa shfaqin tipare të dallueshme gjenetike dhe kulturore në krahasim me japonezët.

## Gjuha arabe

I përket grupit të gjuhëve semite, dhe është ndër më të vjetrat ende në përdorim. Disa mbishkrime në arabisht, datojnë që nga viti 125 Pas Krishtit. Është

një shembull i shkëlqyer se si një gjuha e një kombi të fuqishëm pushtues, mund të vendoset në një zonë të gjerë, dhe të mbijetojë për shekuj në formën e saj origjinale.

## Gjuha aramaike

Kjo gjuhë mburret me afro 3.100 vjet histori të shkruar. Ajo ishte në fillim gjuha e fisit aramean, që u përhap në rajonet e Levantit, Sirisë dhe Mesopotamisë në Lindjen e Mesme, dhe që kishte krijuar një mbretëri që rreth vitit 1000 Para Krishtit. Edhe në kohërat antike, ajo u përdor si një gjuhë mbretërore në disa nga oborret më të vjetra të botës.

## Gjuha kineze

Gjuha kineze është shumë e vjetër, dhe një ndër më uniket në botë. Ajo është shumë komplekse – si në të shkruar, ashtu edhe në të folur – dhe sistemi i saj i shkrimit mund të përbëhet deri në 100 mijë simbole të ndryshme. Forma më e hershme e shkruar e kinezçes, daton që nga viti

1250 Para Krishtit.

## Gjuha perse

Persishtja, e njohur edhe si farsi, është një gjuhë shumë e vjetër indo-evropiane, që i përket nënndarjes indo-iraniane. Ajo flitet nga rreth 70 milionë njerëz në të gjithë botën. Është e gjurmuar në formë të shkruar që në shekullin VI Para Krishtit, por historia e saj është më e vjetër. Persishtja e vjetër, ishte gjuha e Perandorisë Akamenidiane, e cila ekzistoi gjatë viteve 550-330 Para Krishtit, dhe më vonë edhe në Perandorinë Sasaniane. Shkrimi më i vjetër daton nga sundimi i Darit I.

## Gjuha gaelike irlandeze

Është dega irlandeze e gjuhëve goidelike, një pjesë e familjes keltike të gjuhëve indo-evropiane. Shkrimet më të hershme në këtë gjuhë në Irlandë, datojnë nga shekulli IV Pas Krishtit. Pas disa shekujsh shtypje brutale nga pushtuesit anglezë, kjo gjuhë po përjeton sot një ringjallje.

*/ancientorigins/*



E jashtëzakonshme

## Ndërtohet hoteli i parë inteligjent në Greqi, ja çfarë shërbimesh ofron

Vizitorët në qytetin e dytë më të madh të Greqisë, Selanikut, do të jenë në gjendje ta provojnë hotelin e parë inteligjent me 5 vje nga gushti i vitit 2020. Një ndërtesë tetëkatëshe në rrugën 24 Monastiriou u zgjodh strategjikisht si vend ideal në qendër të qytetit të Selanikut dhe u kthye në një hotel me emrin "Onoma" (që do të



thotë 'emër' në anglisht). Falë teknologjisë së zgjuar, hoteli do t'u ofrojë mysafirëve shërbime plotësisht të personalizuar, që ofrojnë ushqim për secilin individ që dëshiron. "Onoma" ka një kapacitet prej 83 dhomash dhe gjithsej 164 shtretër.

FOTO E DITES



Presidenti Donald Trump dhe Zonja e Parë Melania Trump hipën në limuzinën presidenciale përpara fillimit të garës automobilistike Nascar Daytona në Florida. /AP/

E rrallë

## Policia në shok, brenda kamionit gjen një kavanoz me tru njeriu

Autoritetet kufitare në ShBA zbuluan diçka të çuditshme dhe tronditëse gjatë një kontrolli në një kamion postar. Gjatë kontrollit në pikën kufitare me Kanadanë në Michigan, më 14 shkurt, policia gjeti në kamion një kavanoz brenda së cilës ishte një tru njeriu. Kamioni vinte nga



territori kanadez. Autoritetet deklarojnë se drejtuesi i mjetit nuk kishte asnjë dokumentacion për transportimin e organeve njerëzore.

BARSOLETA E DITËS



Flasin dy gjyshe:

- Sa peshon?, e pyet njëra.
- Me syze, 80 kilogramë.
- E pa syze?
- Meqë pa syze nuk e shoh peshoren, nuk di të tregoj.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

<p><b>DASHI</b> Do të prisni edhe shpërblime të rëndësishme, të paktën sa i përket aspektit financiar të biznesit tuaj; do të jeni në gjendje ta promovoni imazhin tuaj, të përmirësoni të ardhurat, të studioni strategji të reja.</p>	<p><b>DEMI</b> Do të dëshironit të rriteni në profesion, por diçka do t'ju pengojë. Jini të durueshëm për disa ditë të tjera dhe pengesat e ndryshme do të zhduken sikur nga magji.</p>	<p><b>BINJAKËT</b> Mundohuni të mos nervozoheni dhe studioni çdo situatë përpara se të merrni ndonjë vendim. Së shpejti do të merrni një hakmarrje të mirë!</p>	<p><b>GAFORRJA</b> Përpiquni të jeni të vëmendshëm ditën e sotme. Do të jetë e dobishme për të mbajtur qetësinë, për t'i ngadalësuar ritmet e përditshme dhe për të dhënë një drejtim të saktë për veprimet tuaja.</p>	<p><b>LUANI</b> Nëse jeni çift, tregoni më shumë vëmendje se zakonisht për nevojat e të dashurit tuaj. Nëse jeni beqar, një takim do të sjellë emocione të mëdha në jetën tuaj.</p>	<p><b>IRGJËRESHA</b> Mos u merrni shumë me veten, por shkoni mbrapa punëve. Krijoni disa pika referimi veçanërisht nga pikëpamja emocionale dhe financiare.</p>
<p><b>PESHORJA</b> Një ditë e shkëlqyer po ju pret, veçanërisht nga pikëpamja profesionale; do të shihni anën pozitive të secilës situatë dhe kjo do t'ju nxisë të zhvillonin dhe zgjeroni nisma të suksesshme.</p>	<p><b>AKREPI</b> Përpiquni të sqaroni një çështje negative që ju ka shqetësuar dhe përpiquni të nxirrni detaje të fshehura.</p>	<p><b>SHIGJETARI</b> Kjo fazë ju përshtatet plotësisht, ju lejon të dilni përpara në jetën shoqërore dhe profesionale!</p>	<p><b>BRICJAPI</b> Do të lulëzojnë ide të reja për ta përballur punën në përgjithësi. Nuk përjashtohet mundësia që dikush të bëjë një punë të madhe!</p>	<p><b>UJORI</b> Yjet ushqejnë nevojën për ta përmirësuar pozicionin profesional dhe rrjedhimisht për t'i rritur të ardhurat.</p>	<p><b>PESHQIT</b> Humori jo fort i mirë do të shoqërohet edhe me lodhje. Kujdesuni për stilin e jetesës dhe merrni me disa aktivitete fizike.</p>



## Vjen në 'jetë' Whitney Houston, më 25 shkurt shfaqja e parë në Britani



**N**jë lajm i mirë për të gjithë fansat e këngëtares së ndjerë Whitney Houston. Këngëtarja do të vijë në "jetë" përmes teknologjisë së hologrameve dhe do të zhvillojë një tur duke filluar nga data 25 shkurt. Tetë vjet pas vdekjes tragjike do të

jetë holograma e këngëtares së mirënjohur që do të zhvillojë një tur evropian muzikor. "Tani është koha e duhur. Në frymën e Whitneyt unë e di që ne po bëjmë gjënë e duhur", ka pohuar Pat Houston, kunata dhe ish-menaxherja e këngëtares.

## Aktorja e njohur turke në zi, humb njeriun më të dashur në jetën e saj



**A**ktorja Fahriye Evcen, njëherësh bashkëshortja e Burak Ozçivit, ka përjetuar një humbje shumë të madhe. Së fundmi babai i saj ka ndërruar jetë. Mediat turke raportojnë se babai i aktores vuante nga një sëmundje e pashërueshme dhe

kohët e fundit ishte shtruar në spital. Dy vjet më parë ai kishte bërë një operacion për kancer në stomak. Fahriye Evcen është e shkatërruar pas ndarjes nga jeta të të atit, i cili ishte njeriu më i dashur për të. Burak po i qëndron pranë në këtë periudhë të vështirë.



## Harry shihet në Kanada duke blerë ushqime

Princi Harry u fotografua duke marrë ushqime në një dyqan në ishullin Vancouver, në Kanada, të enjten. Duka u pa në këtë vend gjatë kohës kur u shpërnda lajmi se ai dhe Meghan duhet të rishikojnë se a do

të përdorin tituj mbretërorë të Sussex për sipërmarrjet e tyre të ardhshme të pavarura. Princi Harry duket se po i përshtatet jetës së tij të re pasi u largua nga familja mbretërore pa probleme dhe të qetë.

## Nikki Reed e ndihmoi Steve Kazeen ta dizajnojë unazën e fejesës për Jenna Dewan



**N**ikki Reed ishte disenjatorja sekrete e unazës së fejesës së Jenna Dewan. Aktorja e "Twilight" e ka uruar miken e saj ku edhe e ka zbuluar se ajo e ka ndihmuar Steve Kazee që ta krijojë unazën me diamante përmes markës së saj për bizhuteri BaYou With Love. "Është nder që isha pjesë e vogël e

këtij momenti kaq të veçantë. Ju dua të dyve dhe krejt çfarë mund të them është se dashuria juaj është magji e pastër. Steve, ta krijojmë këtë unazë së bashku ishte një përvojë vërtet shumë e bukur. Faleminderit që e do Jenna kështu si e do", ka shkruar Reed në një postim në "Instagram Story".

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

## Prishtina kërkon pikët maksimale në Drenicë

Dy klubet që takohen në gjysmëfinale të Kupës, Drenica dhe Prishtina, do ta ndajnë mejdandin sot (e shtunë) në kuadër të Superligës. Kryeqytetasit kanë paralajmëruar se udhëtojnë në Skenderaj për tri pikë, por synim për rezultat pozitiv ka edhe skuadra kuqezi



Prishtina shënoi fitore ndaj Vushtrrisë (4-0). Për ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj foli edhe futbollisti i Prishtinës, Diar Miftaraj. "Pres lojë të vështirë, sepse Drenica tradicionalisht është kundërshtar e papërshtatshme. Jemi maksimalisht të përgatitur për ta vazhduar serinë e fitoreve, sidomos pas dy ndeshjeve rresht të fituara me Vushtrrinë. Atmosferën në ekip e kemi shumë të mirë dhe fitorja eventuale vetëm sa do ta ngritë edhe më shumë për të vazhduar drejt titullit kampion", ka thënë Miftaraj për faqen zyrtare të klubit. "Sa i përket meje, dihet se tash e një kohë jam duke u paraqitur në rolin e qendërmbrojtësit, ashtu ka vendosur trajneri, ndërsa unë po përpiqem ta jap më të mirën për ekipin. Unë do të paraqitem aty ku do të më urd-

hërojnë dhe besoj shumë se jam duke e kryer mirë punën deri tash", ka shtuar Miftaraj. Krahas kësaj ndeshje sot (e shtunë) nga ora 13:00 zhvillohet edhe dueli tjetër në mes të Llapit dhe Feronikelit në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Skenderaj. Tri ndeshjet e tjera zhvillohen nesër (e diel).

**Drita arrin fitore të vështirë në Vushtri**  
Drita nga Gjilani ka shënuar fitore si mysafire në stadiumin "Ferki Aliu", duke e mundur Vushtrrinë me rezultat 3-2. Për gjilanasit kjo

është fitorja e dytë në stinorin pranveror, pasi fundjavën e kaluar triumfoi edhe në derbi kundër Gjilanit. Ndeshja filloi me një minutë heshtje në nderim të ish-futbollistit mitrovicas Gëzim Kaçaniku i cili ndërroi jetë. Rezultati u zhblllokua në minutën e 18 kur Izair Emini realizoi me kokë. Vushtrria barazoi rezultatin në minutën e 31-të me golin e Drilon Fazliut. Por, vetëm katër minuta më pas Drita e riktheu epërsinë me golin e Erjon Vucajt nga distanca. Pak minuta më vonë Drilon Fazliu shënoi nga gjuajtja e lirë, por goli u anulua nga gjyqtari Genc Nuza. Megjithatë, Vushtrria

IPKO SUPERLIGA - Java 19

Vushtrria - Drita 2-3

**Të shtunën takohen:**  
13:00 Llapi - Feronikeli  
13:00 Drenica - Prishtina

**Të dielën takohen:**  
13:00 Ballkani - Ferizaj  
13:00 Gjilani - Flamurtari  
13:00 Trepça '89 - Dukagjini

LIGA E PARË - Java 17

**Të shtunën takohen:**  
Drenasi - Vëllaznimi  
KEK-u - Liria  
Ramiz Sadiku - Arbëria

**Të dielën takohen:**  
Malisheva - Vllaznia (P)  
Besa - Vitia  
Ulpiana - Trepça  
2 Korriku - Dardana  
Onix - Istogu

arriti ta barazojë rezultatin në pjesën e dytë, kur Ahmeti shënoi në minutën e 62-të për 2-2. Por, gëzimi i vendësve zgjati vetëm dhjetë minuta, kur Kastriot Rexha shënoi për epërsinë e tretë të Dritës në këtë takim që në fund doli të jetë edhe goli i fitores.

## Gjilani do të bëhet me pishinë e me fusha tenisi

**GJILAN, 21 SHKURT** - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka vizituar Komunën e Gjilanit, ku është pritur nga kryetari Lutfi Haziri, me të cilin kanë bashkëbiseduar për projektet dhe planet që do të realizohen në këtë regjion. Ministrja Dumoshi ka thënë se vitin e ardhshëm do të fillojë ndërtimi i pishinës gjysmolimpike dhe dy fushave të tenisit. "Jam e nderuar që jam në Gjilan. Gjithashtu, i shprehim ngushëllime familjes Bllaca për tragjedinë. Është vizita ime e parë si ministre në Gjilan. Në aprovimin e buxhetit për këtë vit e njoftova kryetarin që do të ketë investime në rregullimin e



stadiumit të kategorisë së katër mund të zhvillohen lojë miqësore", ka thënë Dumoshi. "Ne kemi tifozë të shkëlqyer të Gjilanit dhe është mirë që lojërat e mëdha të luhen në gjithë Kosovën. E kemi në buxhet palestrën në Gjilan, do ta rregullojmë kulmin dhe nxehtjen. Ne kemi paraparë që t'i ndërtojmë edhe dy fusha të tenisit në Gjilan. Ne do t'i zhvillojmë të gjitha sportet në Kosovë dhe, gjithashtu, unë dje kam pasur një takim me ta dhe flamuri Kosovës do të valojë me shumë sportistë dhe në Komunën e Gjilanit për vitin e ardhshëm do ta fillojmë pishinën gjysmë olimpikë", ka deklaruar Dumoshi. Haziri falën-

deroi ministren Dumoshi për vizitën dhe bëri me dije se është shumë me rëndësi që një ministre e kulturës po e viziton Komunën e Gjilanit. Sipas tij, teatri dhe stadiumi janë disa nga programet ku do të ketë bashkëpunim të madh. "Jam i nderuar që menjëherë pas marrjes detyrës ministria është në vizitë në Gjilan. Po ashtu, e njoftova për kalendarin kulturor dhe biseduam për projektet dhe programet tona. E falënderoj për solidaritetin dhe shpresojmë ta mirëpresim në Gjilan për ndihmesat e mëdha. Teatri dhe stadiumi janë disa nga programet ku do të bashkëpunojmë", ka thënë Haziri.

## Kosova U19, fituese e turneut 'Roma Caput Mundi'

**PRISHTINË, 21 SHKURT** - Në një ndeshje të fortë e të vështirë në ballafaqim me Moldavinë, Përfaqësuesja e Kosovës U19 ka triumfuar me rezultat 1-0 në finale të turneut "Roma Caput Mundi". Trim i këtij dueli final e mjaft të vlefshëm

ishte Ardit Tahiri, i cili shënoi në minutën e 90 dhe ia siguroi fitoren Kosovës. Pjesa e parë ishte me një mbizotërim të lehtë të Moldavisë, por në pjesën e dytë futbollistët "dardanë" u angazhuan më shumë, patën më shumë

raste dhe kjo në fund u kurorëzua edhe me fitore të merituar. Ky turne është pjesë e përgatitjeve të Përfaqësueses U19 për kualifikimet e Kampionatit Evropian që do të zhvillohen në tetor.



## 'Dardanet' pa asnjë humbje e fitojnë turneun në Itali

PRISHTINË, 21 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave e përbërë prej vashave U16, U19 dhe U23, nën udhëheqjen e Kushtrim Munishit, ka triumfuar në turneun ndërkombëtar "Il Calcio E'Rosa" që u zhvillua në Itali me ekipe të kolegjeve të

ndryshme dhe me kombëtare të tjera si Moldavia. Në finalen të këtij turneu futbollistët "dardane" arritën ta mposhtin Moldavinë, me rezultat 3-1 dhe në këtë mënyrë turneun e mbyllën me bilanc prej katër fitoreve, tri në grupin B (Bolzanon 3-0, Lazion C.R. 8-0

dhe Uellsin 5-0). Në ndeshjen e fundit të parat erdhën në epërsi moldavet përmes penalltisë në minutën e 32-të ku shënoi Ceresku dhe vetëm dy minuta më vonë Kaltrinë Biçkaj, po ashtu nga pika e bardhë barazoi shifrat (1-1). Pjesa e dytë nisi furishëm nga vashat e

Kosovës, ku Loreta Lulaj shënoi për epërsinë 2-1. "Dardanet" nuk u ndalën as pas këtij goli dhe në minutën e 60, Kaltrinë Biçkaj shënoi golin e tretë për ekipin dhe të dytin pas një



bashkëveprimi me Donjeta Halilajn. Me këtë rezultat edhe u mbyll ndeshja.

## Besa e Prishtina kërkojnë fitore në derbi

PEJË, 21 SHKURT - Derbi i kësaj jave në Superligën e Kosovës në hendboll do të zhvillohet në Pejë në mes të Besa Famgas dhe Prishtinës. Ndeshja e rëndësishme në garën për titull luhet nga ora 19:00 në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Besa ka fituar të gjitha 15 ndeshjet e deritashme dhe prinë në tabelë me 30 pikë, ndërsa Prishtina është e dyta me 28 pikë. Humbjen e vetme Prishtina e ka pësuar nga Besa. "Jemi të gatshëm ta presim Prishtinën të shtunën. Të gjithë lojtarët janë të gatshëm. Nuk kemi ndonjë lëndim. Do të mundohemi të tregojmë lojë të mirë, që i ka hije një derbi. Ne të shtunën e vazhdojmë traditën e fitoreve", ka thënë trajneri i Besa Famgas, Arben Muqolli. Ndërsa skuadra nga kryeqyteti po synon t'i hakmeret skuadrës së Besës për humbjen në ndeshjen e parë. Trajneri Taib Kabashi ka thënë se në Pejë udhëtojnë për fitore. "Gjithmonë ndeshjet në mes të Prishtinës dhe Besës kanë qenë



të forta dhe interesante. Asnjëherë nuk është ditur fituesi deri në minutën e fundit. Edhe këtë herë pritet të jetë lojë e fortë dhe përcaktuese për vendin e parë. Takohen dy ekipet më të mira në Superligë për momentin, i pari me të dytin. Besa është në përparësi të lehtë, por ne jemi përgatitur në të gjitha aspektet për këtë derbi.

Në Pejë udhëtojmë vetëm për fitore. I dimë përparësitë dhe dobësitë e Besës. Do të përpiqemi t'i shfrytëzojmë maksimalisht", ka thënë Kabashi. Sot (e shtunë) është edhe ndeshja në mes të Kastriotit dhe Llapit, që fillon në orën 14:30. Dy ndeshjet e fundit të javës së 16-të janë të dielën: Trepça - Drenica (17:00), Drita - Prizreni (18:00).

## Milwaukee ruan kreun në Lindje

DETROIT, 21 SHKURT - Pas një pushimi 10-ditor për shkak të "All Star Game" kanë rinisur ndeshjet e NBA-së. Skuadra e Milwaukee mposhti me rezultat 126-106 Detroitin jashtë fushës, duke ruajtur kreun në Lindje dhe mban rekordin më të mirë sezonal. Ndeshje e dominuar nga Milwaukee, ku u dallua i zakonshme Antetokounmpo, që realizoi 33 pikë e 16 rebounde, mbështetur edhe nga Middleton me 28 pikë. Jashtë fushës fitore ka regjistruar edhe Houstoni, që e mposhti me rezultat 135-105 Golden Staten, ndeshje që ishte një formalitet për teksanët. Të gjithë titullarët e Houstonit realizuan mbi 10 pikë, me Hardenin



që realizoi 29 pikë e 10 asistime, ndërsa Westbrooku e mbylli me 21 pikë e 10 asistime. Fitore në sekondat e fundit për Sacramenton, që mposhti 129-125 Memphisin, sfidë ku diferencën e bëri Barnes me 32 pikë. Pas kohës shtesë triumfon skuadra e Philadelphias, që mundi me rezultat 112-104 Brooklyn, ndeshje me rivalitet

dhe emocione. Embiid ishte lider në fushë për Philadelphian, autor i 39 pikëve e 16 reboundeve, mbështetur edhe nga Harris me 22 pikë e 12 rebounde. Fiton edhe skuadra e Atlantës, që mundi 129-124 Miamin, sfidë ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Trae Young me 50 pikë ishte më i miri në fushë për Atlantan.

### REZULTATET

Detroit - Milwaukee	106-126
Atlanta - Miami	129-124
Chicago - Charlotte	93-103
Philadelphia - Brooklyn	112-104
Sacramento - Memphis	129-125
Golden State - Houston	105-135

### SHKURT

#### Interi e ka seriozisht interesimin për Kumbullën

Interi duket i vendosur për ta transferuar Marsh Kumbullën në afatin kalimtar të verës. Zikaltrit janë impresionuar nga paraqitjet e shqiptarit, i cili luan me fanellën e Hellas Veronës në Serinë A. Siç raporton e përditshme veroneze "L'Arena", zikaltrit janë të gatshëm të sakrifkohen dy të rinjtë e skuadrës së tyre, sulmuesin 17-vjeçar Sebastjano Esposito dhe mbrojtësin 20-vjeçar Alesandro Bastoni. Klubi i Veronës, për ta lënë të lirë Marsh Kumbullën, kërkojnë të paktën 30 milionë euro, gjithmonë nëse nuk do të ketë futbollistë të huazuar në tratativa.

#### Williani mund të largohet nga Chelsea

E ardhmja e Willianit te Chelsea është ende në pikëpyetje teksa braziliani ka vetëm pak muaj kontratë të mbetur me klubin. 31-vjeçari ka zbuluar se ka marrë pasaportën britanike dhe se Londra për të dhe për familjen e tij është bërë një atdhe i dytë ndaj nuk dëshiron të largohet. Braziliiani i ka dhënë prioritet rinovimit me Chelsea, por nëse nuk do të ndodhë, nuk përjashtohet kalimi i tij në një prej klubeve të tjera të Londrës si Tottenham, Arsenal apo West Ham.

#### Juve insiston në rikthimin e Pogbas

Paul Pogba pritet të largohet nga Manchester Unitedi në afatin kalimtar të verës. Juventuesi është skuadër shumë e interesuar për shërbimet e francezit, i cili më shumë sukses ka luajtur edhe në të kaluarën për "Zonjën e Vjetër". "Tuttosport" raporton se Juve po mendon të ofrojë një shumë të hollash edhe shërbimet e mesfushorit Aaron Ramsey për Pogban. Çmimi i reprezentuesit të Francës ka rënë dukshëm dhe tash besohet se ai vlen 70 milionë euro.

#### Sterling: Ndaj Realit të tregojmë se sa të mirë jemi

Raheem Sterling ka deklaruar se te Manchester City janë në dijeni se sfida kundër Real Madridit nuk do të jetë e lehtë. Manchester City dhe Real Madridi do t'i matin forcat në Ligën e Kampionëve, në 1/16 finales. Ndeshja e parë do të luhet më 26 shkurt, në 'Santiago Bernabeu'. "Po, e dimë se sa ndeshje e vështirë do të jetë", ka deklaruar Sterling për AS, teksa ka folur për sfidën kundër Real Madridit. "Ky është një nga testet më të rëndësishme të karrierës sonë. Unë mendoj se është një vit i shkëlqyeshëm për ne në Ligën e Kampionëve, sepse në Premierligë gjërat nuk kanë shkuar siç kishim planifikuar". "Është shansi ynë të dalim dhe të tregojmë se sa të mirë jemi. Sot nuk ka shumë ekipe që mund të na ndalojnë".

#### Hendersoni mungon tri javë

Kapiteni i Liverpoolit, Jorgan Henderson, do të jetë jashtë fushës së lojës për tri javë, shkak i një lëndimi muskolor. Lajmin e ka konfirmuar trajneri Jurgen Klopp. "Mund të kishte qenë edhe më keq. Ishte lëndim muskolor, por nuk është edhe aq keq. Ai do të jetë jashtë skuadrës për tri javë ose diçka e tillë. Nuk është një gjë e mirë, por ne prapëseprapë besojmë se ishim me fat në këtë rast", ka thënë Klopp. Kapiteni i Liverpoolit u zëvendësua në fund të ndeshjes së Ligës së Kampionëve kundër Atletico Madridit.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "EKO – DIZEL" SH.P.K me seli në Mamushë ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit: 810113738 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore- Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30- ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavještavamo sve klijente da Tvrtka "EKO- DIZEL" D.O.O u Mamuša doneo odluku da ugasi biznis. Po br.registra: 810113738 i ujedno imenova Likfidatora o sprovodjenju postuaka likfidacije.

Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana objavljnja o novine.

## ANNOUCEMENT

All clients are to be informed that the Company "EKO- DIZEL" LLC in Mamusa has come to the decision to quit its business with registry: 810113738. The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage accounts in this company are kindly request to show up withing 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

Data: 21.02.2020

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "Fellas" SH.P.K. me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit 811353002 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavamo sve klijente da Tvrtka "Fellas" SH.P.K. u Prizrenu donela odluku da ugasi biznis pod registarkim brojem 811353002 i ujedno imenovala likuidatora o sprovodjenju likudacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi da se jave u roku od 30 dana od dana objavljnja u novine

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the company "Fellas" SH.P.K. in Prizren has come to the decision to quit its business with registry number 811353002. All clients who have the debit-credit accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of the newspaper announcement publication.



## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

**Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë. Për informata në tel: 044-444-009**

► Hysni Hasani, shpall të pavlefshme dëftesat (kl. I - VIII ) SHF. "28 Nëntori " Polac.

► Leutrim Mulaj, shpall të pavlefshme dëftesat e vitit (I - II) SHMT "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

**Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.**



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike  
 Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave - Ministry of Internal Affairs and Public Administration

**KONKURS**

Në bazë të Nenit 14 të LIGJI Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike shpall konkurs për këtë vend pune:

**Titulli i vendit të punës:**

Drejtor të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

**KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE**

Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Qendrore duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, dhe Neni 9 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si vijon:

- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara:
  - në administrim të biznesit;
  - financa të korporatave;
  - financa publike;
  - menaxhim thesari;
  - banka;
  - biznes konsultimesh;
  - industri ose
  - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Në rast të numrit të lartë të aplikacioneve, kriteret e mëposhtme të dëshirueshme do të përdoren për të vlerësuar aplikacionet, me ç' rast kandidatët e pasuksesshëm do të eliminohen në fazën e shqyrtimit të CV-ve në procesin e rekrutimit:

- Diplomë Bachelor
- Diplomë Master,
- Kualifikimi profesional pas -diplomimit,
- Anëtarë i një shoqate profesionistësh të pranuar në nivel kombëtar
- Përvoja e punës në institucione/projekte ndërkombëtare,
- Përvoja e punës në pozitë drejtori ekzekutiv,
- Aftësia për të folur dhe të shkruar rrjedhshëm një gjuhë të huaj.

**KUSHTET**

Një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:

- Ka qenë i dënuar dhe është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:

- Aktualisht është zyrtar, menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose cilëso nga filialet e saj;
- Ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike) i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë e sipërpërmendura.
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.

**AFTESITE PERSONALE TE KËRKUARA**

- Udhëheqje
- Pune ekipore
- Përdorimi i internetit
- Të menduarit strategjik
- I/e orientuar ndaj rezultateve
- Vendim-marrja
- Aftësi ndikuese
- Koherencë të qartë, komunikim konciz
- Integritet
- Vetëdije
- Të menduarit kreativ

**KOHËZGJATJA E MANDATIT:**

Mandati i secilit anëtar të Bordit është katër (4) vjeçar, me mundësi emërimi edhe për një mandat tjetër në vazhdim. Mandati i secilit anëtar të Bordit fillon nga data e emërimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente (Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit):

- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë
- Letër motivim
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Zyra e Personelit, zyra nr. 320, kati III, ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/ 200 30 185.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i anëtarëve të Bordit, përcaktohen nga Kuvendi deri në nxjerrjen e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publik.

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (nga data 22 shkurt deri me 22 mars 2020).

RESTAURANT

---

**SWISS**

---

TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156    +386 49 848 553

PRISHTINË

## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave - Ministry of Internal Affairs and  
Public Administration

## KONKURS

Na osnovu člana 14. Zakona br. 05/L - 085 o električnoj energiji, Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave objavljuje konkurs za ovo radno mesto:

### Naziv radnog mesta:

Direktor odbora operatera prenosnog sistema.

### KVALIFIKACIJE I PROFESIONALNA PODOBNOST

Da bi jedan kandidat bio izabran za direktora Odbora u Centralnom javnom preduzeću, mora imati kvalifikacije i radno iskustvo u skladu sa članom 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, i člana 9. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, i to:

- Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva na visokom nivou upravljanja u sledećim oblastima:
  - u poslovnoj administraciji;
  - korporativnim finansijama;
  - javnim finansijama;
  - upravljanje trezorom;
  - banke;
  - poslovnim konsultacijama;
  - industriji ili
  - da je radio najmanje 5 godina kao ovlašćeni računovođa, kvalifikovani pravnik, ili kvalifikovani član bilo koje druge profesije koja je povezana za poslovnu delatnost Centralnih javnih preduzeća.

U slučaju velikog broja aplikacija, sledeći poželjni kriterijumi biće korišćeni za procenu aplikacija, pri čemu neuspešni kandidati biće eliminisani u fazi razmatranja biografija u procesu regrutovanja:

Diploma osnovnih studija  
Diploma master studija,  
Postdiplomske profesionalne kvalifikacije,  
Član nacionalno priznatog profesionalnog udruženja  
Radno iskustvo u međunarodnim institucijama/projektima,  
Radno iskustvo na položaju izvršnog direktora,  
Sposobnost da tečno govori i piše jedan strani jezik.

### USLOVI

Osoba nema pravo vršenja funkcije direktora u Odboru centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:

- Bio osuđen ili je pod istragom nadležnog suda;
- Prekršio etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, osim ako je ta kazna preinačena od strane suda ili drugog žalbenog organa;
- Lažno svedočio pod zakletvom;
- Bio na rukovodećoj funkciji u kompaniji koja je bankrotirala tokom poslednjih deset (10) godina.
- Ne radi u bilo kojoj instituciji koja kreira razvojne politike za Javna preduzeća kod kojih kandidat aplicira.

Kandidat ne može biti izabran za direktora Odbora centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:

- Trenutno je službenik, menadžer dotičnog Javnog preduzeća, (u smislu člana 21. Zakona o javnim preduzećima), ili bilo koje od njenih filijala;
- Služio kao službenik ili menadžer dotičnog Javnog preduzeća, ili bilo koje od njenih filijala, tokom proteklih pet (5) godina;
- Trenutno, ili tokom proteklih tri godina, se nalazi u bilo kakvim materijalnim poslovnim odnosima (osim kao individualni korisnik usluga Javnih preduzeća) sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala, bilo da je to direktno ili indirektno;
- Akcionar, direktor ili službenik u privrednom društvu ili drugom pravnom licu, koji ima materijalne poslovne odnose sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala;
- Prima, ili je primao tokom prethodne tri (3) godine, dodatnu kompenzaciju od dotičnog Javnog preduzeća ili od bilo koje od njenih filijala (osim honorara za direktora ili stimulativne kompenzacije utvrdene članom 20.1 Zakona o javnim preduzećima), ili je član penzione šeme dotičnog javnog preduzeća ili bilo koje njene filijale;
- Predstavlja akcionara koji poseduje više od deset odsto (10%) akcija sa pravom glasa u dotičnom Javnim preduzeću;
- Služio u Odboru direktora dotičnog Javnog preduzeća više od devet (9) godina od datuma njegovog/njenog prvog izbora;
- Rodak u trećem kolenu (kao što je utvrđeno u skladu sa definicijom "Finansijskog interesa" u članu 2. Zakona o javnim preduzećima) bilo koje osobe koja pripada nekoj od gore navedenih kategorija.
- Službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u privrednom društvu koje konkuriše sa Preduzećem, ili je viši menadžer, službenik, direktor ili akcionar (koji poseduje više od dva odsto (2%) prava glasa), ili ima značajan finansijski interes u bilo kom od privrednih društva koje konkurišu sa Preduzećem;
- Trenutno, ili u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma apliciranja, bio je javno izabrani zvaničnik, politički imenovan ili nosilac rukovodeće funkcije ili donosilac odluka u političkoj stranci;
- Ima bilo kakav sukob interesa koji bi po prirodi prouzrokovao da ova osoba ne bude u stanju da rutinski, pouzdano, nezavisno i objektivno ispunjava svoje finansijske obaveze prema akcionarima i javnim preduzećima.

### POTREBNE LIČNE SPOSOBNOSTI

- Liderstvo

- Timski rad
- Korišćenje interneta
- Strateško razmišljanje
- Orijentisanje na rezultate
- Odlučivanje
- Uticajne sposobnosti
- Jasnu koherentnost, koncizna komunikacija
- Integritet
- Svest
- Kreativno razmišljanje

### TRAJANJE MANDATA:

Mandat svakom članu Odbora traje četiri (4) godine, uz mogućnost imenovanja na još jedan mandat. Mandat svakom članu Odbora počinje od dana imenovanja od strane Skupštine Republike Kosovo.

### OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA ZA KONKURISANJE

Kandidati za direktore u Odboru javnog preduzeća moraju dostaviti sledeća dokumenta (Neuspeh dostavljanja sledećih dokumenata rezultiraće odbacivanjem aplikacije):

- Biografija u kojoj su navedeni primeri uspeha u radu
- Motivaciono pismo
- Izjavu pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije)
- Dokumentacija predviđena prema uslovima za zapošljavanje (potvrde o profesionalnoj kvalifikaciji, radnom iskustvu)
- Sertifikat (potvrdu) koji dokazuje da nije pod istragom
- Državljanin Kosova (kopiju pasoša ili lične karte).

Podnosilac aplikacije mora lično popuniti izjavu pod zakletvom prilikom apliciranja, u kojoj izjavljuje da on/ona ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnosti i profesionalne podobnosti. Svako materijalno lažno predstavljanje, bilo da je to namerno ili nenamerno, ili materijalna promena od datih informacija u gore navedenoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Dokumentacija treba da bude dostavljena u zapečaćenoj koverti na kojoj treba napisati ime i prezime kao i naziv Javnog preduzeća u kojoj kandidat konkuriše i dostaviti Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave, kadrovskoj službi, kancelarija br. 320, sprat III, zgrada Palate štampe, Priština, ili putem elektronske pošte na linku: <http://map.rks-gov.net> Dostavljena dokumentacija se ne vraća. Originali su potrebni tokom intervjua.

Za dodatne informacije pozovite na broj telefona 038/ 200 30 185.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su izabrani za intervju.

Iznos za naknadu članova Odbora utvrđuje Skupština do donošenja odgovarajućeg Zakona o platama visokih javnih funkcionera.

Konkurs je otvoren 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi (od 22 februar do 22. mart 2020).

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

